

PK. SH.A.
Posta e Kosovës SH.A.
Post of Kosovo J.S.C.
Pošta Kosova B.D.

Nr./No./Br.

01-485-1/25

Data/Date/Datum

14-03-2025

PRISTINE-PRISTINA-PRISTINA



posta 

Raport vjetor 2024

Tabela e përmbajtjes

Hyrje.....	5
Historiku i ndërmarrjes.....	5
MISIONI DHE VIZIONI.....	6
Përmbledhje FAKTE KYÇE.....	7
Struktura Organizative e PK Sh.A.....	8
Skema e re organizative e PK Sh.A.....	8
Fjala e Kryesuesit të BD.....	10
Fjala e Kryeshefes Ekzekutive.....	11
Zhvillimi i qëndrueshëm.....	12
Bordi i Drejtorëve.....	14
Aktivitetet dhe performanca e ndërmarrjes.....	14
Aktivitetet kryesore të ndërmarrjes gjatë vitit 2024.....	14
Pasqyra e performancës operative dhe financiare në krahasim me vitin paraprak dhe planifikimin e vitit aktual..	15
Ngjarjet të cilat ndikojnë në të ardhmen e ndërmarrjes.....	15
Të priturat për vitin e ardhshëm.....	15
Informacione lidhur me kapitalin dhe dividendën.....	15
Të dhënat për drejtorët jo ekzekutiv.....	15
Ngjarjet kryesore të vitit 2024.....	17
Drejtoria e Përkrahjes - DP.....	17
Departamenti i Administratës.....	18
Departamenti i Resurseve Njerëzore.....	19
Rekrutime.....	19
Struktura e të punësuarve në PK Sh. A.....	20
Trajnimet dhe zhvillimi.....	20
Departamenti për Çështje Ligjore.....	21
Departamenti i Teknologjisë Informative	21
Drejtoria e Shërbimeve Postare.....	22
Aktivitetet kryesore të Drejtorisë së Shërbimeve Postare gjatë vitit 2024.....	22
Drejtoria e Zhvillimit të Biznesit.....	25
Zhvillimet Operative.....	26
Aktivitetet e Shitjes.....	30
Aktivitetet e realizuara nga Filatelia gjatë vitit 2024.....	31
Kujdesi ndaj Konsumatorëve.....	32
Marketingu.....	32
Departamenti i Prokurimit.....	33
Inspektorati.....	34

Pasqyra vjetore e inspektimeve.....	34
Efektet e inspektimeve dhe aktiviteteve përgjatë vitit 2024.....	34
Kontrulli i Brendshëm.....	35
Aktivitetet e DKB-së të realizuara për gjatë vitit 2024.....	35
Drejtoria e Financave - DF.....	36
Departamenti i Institucionit Financiar Jo Bankar - DIFJB.....	36
Aktivitetet e IFJB gjatë vitit 2024 si dhe numri i pagesave.....	36
Shpërndarja e Asistencave Sociale gjatë vitit 2024.....	36
Performanca operative dhe indikatorët kyç të performancës.....	37
Performanca financiare dhe rezultatet.....	37
Pasqyrat e vitit 2024.....	38
Indikatorët kyç financiar.....	39
Progresi me Planin e Biznesit.....	41
Shpenzimet Kapitale dhe të Projekteve.....	41
Realizimi i Projekteve Kapitale 2024.....	41
Investimet Kapitale -Tecnologjia Informative.....	42
Perspektiva Strategjike për Vitin 2025 – PK Sh.A.....	42
Objektivat strategjike të kompanisë për periudhën e ardhshme.....	44
Rreziqet kryesore dhe masat e menaxhimit në Postën e Kosovës Sh.A.....	45
Përfundim.....	47

Tabela e shkurtimeve

AP	Administrata Postare
ARKEP	Autoriteti Rregullativ i Komunikimeve Elektronike dhe Postare
AS	Asistencë Sociale
ARC	Agjencia e Regjistrimit Civil
PB	Plani i Biznesit
BD PK	Bordi i Drejtorëve i Postës së Kosovës
BQK	Banka Qendrore e Kosovës
CDS	Costumes Declaration Standards
DP	Drejtoria e Përkrahjes
DA	Departamenti i Administratës
DRN	Departamenti i Resurseve Njerëzore
DZHB	Drejtoria e Zhvillimit të Biznesit
DO	Departamenti i Operativës
DSHP	Drejtoria e Shërbimeve Postare
DF	Drejtoria e Financave
DÇL	Departamenti për Çështje Ligjore
DK	Dogana e Kosovës
DKB	Departamenti i Kontrollit të Brendshëm
KNK	Kujdesi ndaj Konsumatorëve
DP	Departamenti i Prokurimit

DPH	Departamenti i Postës Hibride
DSH	Departamenti i Shitjes
DTI	Departamenti i Teknologjisë Informative
DIFJB	Departamenti i Institucionit Financiar Jo Bankar
EDI	Electronic Data Interchange
IFJB	Institucioni Financiar Jo Bankar
IKP	Indikatorët Kyç të Performancës
ICS2	International Costumes Standarde 2
IP	Inspektorati Postar
KMSH	Kosto e Mallit të Shitur
KPP	Komisioni për Pulla Postare
KQZ	Komisioni Qendror i Zgjedhjeve
KURP	Kompania e Ujësjetës Rajonal Prishtina
MAPL	Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal
MPB	Ministria e Punëve të Brendshme
MPJD	Ministria e Punëve të Jashtme dhe Diasporës
MPMS	Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale
OE	Operator Ekonomik
PK	Posta e Kosovës
PN	Posta Ndërkombëtare
PV	Posta Vendore
PTT	Posta, Telefoni dhe Telegrafi i Kosovës
PSO	Procedurat Standarde të Operimit
QKK	Qendra e Kujdesit ndaj Konsumatorëve
SASP	Sistemi i Automatizimit të Sporteve të Postës
SW	Softuerë
SHFJB	Shërbimet Financiare Jo Bankare
SHPK	Shoqëri me Përgjegjësi të Kufizuara
SHUP	Shërbimet Universale Postare
TEB	Turk Ekonomi Bankasi
UA 2005/4	Udhëzimi Administrativ 2005/4
UPU	Unioni Postar Universal
UNODC	United Nations Office on Drugs and Crime
ZKA	Zyra Kombëtare e Auditimit
ZKFTH	Zyrtari Kryesor i Financave dhe Thesarit
ZP	Zyrat Postare

Tabela 1: Bordi i Drejtorëve.....	16
Tabela 2: Statistika nga aktiviteti i Bordit të Drejtorëve për vitin 2024.....	16
Tabela 3: Komisioni i Auditimit.....	17
Tabela 4: Statistika nga aktiviteti i Komisionit të Auditimit për vitin 2024.....	17
Tabela 5: Struktura e të punësuarve në PK Sh. A. sipas gjinisë.....	20
Tabela 6: Kursimet/të hyrat nga TI.....	22
Tabela 7: Pasqyra vjetore e vëllimit fizik të dërgesave postare në trafikun e brendshëm-Posta Vendore 2024.....	23
Tabela 8: Pasqyra vjetore e vëllimit fizik të dërgesave postare në shkuarje - ardhje Posta Ndërkombëtare 2024.....	23
Tabela 9: Statusi i zyrave postare në periudhën përmyllëse të vitit 2024.....	26
Tabela 10:Të hyrat nga shërbimet postare vendore/ konsumatorët e mëdhenj.....	27
Tabela 11: Të hyrat nga shërbimet Vala/Telekom.....	28
Tabela 12: Të hyrat nga dërgesat online targetet/arritshmëria Janar - Dhjetor 2024.....	28
Tabela 13: Të hyrat nga shërbimet postare - Posta Ndërkombëtare.....	29
Tabela 14: Të hyrat nga shërbimet tjera postare në vitin 2024.....	29
Tabela 15: Kontratat e arritura gjatë vitit 2024 krahasuar me 2023.....	30
Tabela 16. Inspektimet e planifikuara dhe të realizuara gjatë vitit 2024.....	34
Tabela 17: Verifikimi elektronik i listave të nënshkrimeve dhe prezencës së punonjësve në punë gjatë vitit2024.....	35
Tabela 18: Numri i pagesave / transaksioneve të realizuara gjatë viteve 2023 dhe 2024.....	36
Tabela 19: Shpërndarja e Asistencave Sociale gjatë vitit 2024.....	36
Tabela 20: Qarkullimi i përgjithshëm dhe të hyrat gjatë viteve 2023-2024.....	37
Tabela 21: Planifikimi dhe realizimi gjatë vitit 2024.....	37
Tabela 22: Pasqyra e të ardhurave.....	38
Tabela 23: Indikatorët financiar.....	39
Tabela 24: Statusi i projekteve të PK Sh.A.....	42
Figura 1: Struktura Organizative e PK Sh.A.....	8
Figura 2: Struktura Organizative e re e PK Sh.A.....	9
Figura 3: Krahasimi i shpenzimeve të derivateve për vitin 2024 me vitin 2023.....	18
Figura 4: Krahasimi i shpenzimeve komunale për vitin 2024 me vitin 2023.....	19
Figura 5: Shërbimet Postare.....	27
Figura 6: Krahasueshmëria e realizimit 2024-2023.....	28
Figura 7: Krahasimi i realizimit të të hyrat nga dërgesat online - 2024 me 2023.....	28
Figura 8: Krahasimi i të hyrat nga shërbimet tjera postare 2024 më 2023.....	29
Figura 9: Krahasimi i kontratave 2024 – 2023.....	30
Figura 10. Paraqitja grafike - Krahasimi i arritshmërisë në rrjete sociale 2023 - 2024.....	32
Figura 11: Paraqitja grafike e të hyrave.....	38
Figura 12: Paraqitja grafike sipas llojit të të hyrave.....	39
Figura 13. Paraqitja grafike e shpenzimeve.....	39

Hyrje

Raporti Vjetor për vitin 2024 është përpiluar bazuar në dispozitën e nenit 31.3 të Ligjit nr. 03/L-087 për Ndërmarrjet Publike.

Raporti është punuar sipas formës së aprovuar nga Njësia për Politika dhe Monitorim të Ndërmarrjeve Publike, ndërsa përmbajtja e tij është e bazuar në “Udhëzuesin për përpilimin e raportit vjetor të ndërmarrjes publike”.

Raporti paraqet rezultatet kryesore të aktiviteteve të Menaxhmentit të PK Sh.A. në përmbushjen e detyrave dhe obligimeve gjatë vitit 2024, si dhe të aktiviteteve krahasuar me planin vjetor dhe shkallën e realizimit.

Bord i Drejtorëve i PK Sh.A. në përmbijlljen e vitit 2024 ka paraqitur raportin e Bordit të Drejtorëve. Në këtë raport është paraqitur fjala hyrëse e Kryesuesit të Bordit, aktivitetet e Bordit, si dhe rregulloret e aprovuara në këtë periudhë.

Historiku i ndërmarrjes

Posta, Telefoni dhe Telegrafi i Kosovës (PTT) është themeluar në vitin 1959. Në vitin 1999 është ndryshuar emërtimi nga PTT në PTK (Postë Telekom i Kosovës). Prej datës 01.08.2012, Posta e Kosovës (PK Sh.A.) operon si entitet i ndarë nga PTK Sh.A.

Me suprimimin e autonomisë së Kosovës, si në çdo institucion tjetër të Kosovës, punëtorët shqiptarë u dëbuan nga PTT-ja. Me përfundimin e luftës, konkretisht më 02.08.1999, punonjësit e dëbuar u rikthyen në vendet e tyre të punës.

Punonjësit e Postës së Kosovës, me një vullnet të pathyeshëm dhe duke u bazuar në Rregulloren e UNMIK-ut nr. 12/99, u angazhuan për rimëkëmbjen e ndërmarrjes. Edhe përkundër vështirësive të mëdha, u realizua infrastruktura e domosdoshme, duke filluar nga improvizimi i zyrave postare që mungonin, pajisja me thasë postare, pulla postare, çmimoren e shërbimeve (ku përcaktohen edhe vendet fqinje të Postës së Kosovës), formularët, udhëzimet, kodi aero-postar, e deri tek vulat postare të aprovuara nga UPU-ja. Më datën 31 maj të vitit 2000 u vendos që të fillojë së vepruari Posta e Pavarur Ndërkombëtare e Kosovës. Njëkohësisht u formua edhe Zyra Këmbyese Ndërkombëtare Prishtina LC/AO dhe CP, përmes së cilës u përmbushën kriteret e përcaktuara nga UPU-ja për të filluar këmbimin e dërgesave postare në tërë botën.

Më 1 korrik 2005, PTK-ja shndërrohet në korporatë – PTK Shoqëri Aksionare (Sh.A.), ku Posta e Kosovës vepron si një njësi biznesi brenda saj. Gjatë vitit 2012, me vendim të Qeverisë së Kosovës, gjegjësisht Ministrisë për Zhvillim Ekonomik, Posta e Kosovës iu nënshtrua procesit të konsolidimit. Nga data 21.05.2012, PK u regjistrua si “Shoqëri Aksionare”, kurse veprimtarinë si NPQ e filloi më 01 gusht 2012.

PK Sh.A., nga data 01.08.2012, me vendim të aprovuar në Parlamentin e Kosovës, është ndërmarrje publike me aksionar Qeverinë e Republikës së Kosovës. Posta e Kosovës Sh.A. është 100% në pronësi të Republikës së Kosovës, e mbikëqyrur përmes Ministrisë së Zhvillimit Ekonomik (tash Ministria e Ekonomisë).

Si ndërmarrje e licencuar për këtë fushë-veprimtari, veprimtaria kryesore e saj është ofrimi i produkteve/shërbimeve postare, si dhe ofrimi i shërbimeve për biznese, si shitja e produkteve/shërbimeve të telefonisë mobile e fikse, me një shtrirje të rrjetit të shitjes në të gjithë territorin e Republikës së Kosovës.

Implementimi i projekteve kapitale, si automatizimi i sporteleve, Posta Hibride, track & trace, etj. janë edhe një avantazh më tepër, që konsumatorët si zgjedhje të parë dhe më të preferuar për kryerjen e shërbimeve postare të vazhdojnë ta kenë Postën e Kosovës.

Vlerat kryesore të ndërmarrjes janë përkushtimi për ofrimin e produkteve/shërbimeve cilësore për konsumatorë, arritja e vet-qëndrueshmërisë financiare, minimizimi i humbjeve/maksimizimi i fitimit, rritja e imazhit dhe besueshmërisë të konsumatorët dhe të qenit transparent.

Posta e Kosovës, si operator i vetëm publik postar, aktivitetin e vet e zhvillon në mbarë territorin e Kosovës. E organizuar në shtatë regjione, e bën shpërndarjen e të gjitha dërgesave që arrijnë nga bota në Kosovë dhe anasjelltas, si dhe të atyre që mbliidhen në Kosovë dhe kanë për destinim qendrat e ndryshme të Kosovës.

Në anën tjetër, Posta e Kosovës posedon 203 zyra postare (përfshirë 36 ZP jashtë funksionit dhe 15 ZP të uzurpuara). Në zyrat postare aktive (152 ZP) vazhdojnë të kryhen shërbime postare, ku gjithashtu bëhet edhe mbledhja e dërgesave postare, të cilat pas përpunimit në Qendrën Transite Postare (QTP), rrugëtojnë nëpër shtete të ndryshme të botës (dërgesat me destinim ndërkombëtar), ndërsa ato që janë me destinim vendor shpërndahen nëpër regjione.



Misioni

Misioni i Postës së Kosovës është që përmes ngritjes së cilësisë së shërbimeve postare dhe zgjerimit të gamës së shërbimeve tjera komerciale, të njihet për cilësi dhe besueshmëri jo vetëm në rajon, por edhe më gjerë, duke i përmbushur kërkesat e Bashkimit Evropian për cilësi dhe standarde.

Vizioni


Vizioni i Postës së Kosovës është që të ofrojë shërbime postare dhe shërbime tjera komerciale për qytetarët, bizneset, institucionet dhe organizatat e ndryshme në tregun vendor dhe atë ndërkombëtar, duke ofruar shërbime të standardeve të larta dhe shërbime inovative në hap me kërkesat e tregut, krahas zhvillimeve më të reja në teknologjinë informative.

Përmbledhje - FAKTE KYÇE

Te hyrat	EBITDA	Fitimi Neto
10,4 MLN	1,7 MLN	286 K
Të hyrat e vitit 2024 vijnë kryesisht nga rritja e të hyrave nga shërbimet postare dhe ato të pagesave, duke pasur një ndikim të rëndësishëm në rezultatet financiare.	Gjatë vitit 2024, EBITDA arriti në 1.7 milion, duke shënuar një rritje prej 16.53% krahasuar me vitin 2023 (1.4 mln). Kjo rritje është rezultat i zvogëlimit të shpenzimeve operative dhe rritjes së efikasitetit në menaxhimin e kostove.	Fitimi neto për vitin 2024 arriti në 286,472 euro, si rezultat i rritjes së të hyrave dhe menaxhimit efikas të shpenzimeve operative. Ky rezultat pozitiv pasqyron përmirësimin e qëndrueshëm të performancës financiare të kompanisë, duke u mbështetur në strategji të suksesshme për rritjen e efikasitetit operacional, zvogëlimin e kostove dhe optimizimin e resurseve. Ky rezultat është një tregues i qartë i përkushtimit të kompanisë ndaj krijimit të vlerës afatgjatë për aksionarët dhe mbajtjes së një pozite të fortë në treg, ndërkohë që siguron një bazë të qëndrueshme për rritjen e mëtejshme dhe stabilitetin financiar.
3.51%	16.63%	K.Fin.


Në vitin 2024, të hyrat vjetore shënuan një rritje prej 3.51% në krahasim me vitin 2023, duke reflektuar një përmirësim qëndrueshëm në performancën financiare të kompanisë.

Raporti vjetor për vitin 2024 tregon një EBITDA prej 1,705,041€, duke shënuar një rritje prej 16.63% krahasuar me vitin 2023. Kjo rritje reflekton përmirësimin e performancës financiare të kompanisë, duke evidentuar efikasitet më të lartë në menaxhimin e kostove dhe arritjen e objektivave strategjike për këtë periudhë. Performanca e qëndrueshme e kompanisë gjatë vitit 2024 tregon angazhimin në optimizimin e proceseve operative dhe rritjen e rentabilitetit operativ.



Struktura Organizative e PK Sh.A.

Figura 1: Struktura Organizative e PK Sh.A.



PK, S.H.A.
 Posta e Kosovës S.H.A.
 Post of Kosovo J.S.C.
 Posta Kosova D.O.
 Nr./No./Nr. 01-3743/16
 Data/Date/Datum 27-12-2016
 PRISHTINË-PRISTINA-PRISTINA

Skema e re organizative e PK Sh.A.

Në bazë të nenit 30, pikat 1 dhe 12 të Statusit nr. 01-979/2023, të datës 25.04.2023, Bordi i Drejtorëve i NPQ “Posta e Kosovës” Sh. A. në mbledhjen nr. 12/2023, të mbajtur më datë 03.08.2023, ka miratuar nivelin e parë të skemës organizative të ndërmarrjes në nivel të numrit të drejtorive dhe departamenteve të NPQ “Posta e Kosovës” Sh.A.


Skema e re organizative në nivel të drejtorive, sipas pikës 1 të këtij vendimi, ka reduktuar numrin e drejtorive (nga 8 drejtori sipas skemës paraprake, në 4 drejtori sipas skemës së re).

Në vijim janë të paraqitura drejtoritë sipas skemës së re të NPQ “Posta e Kosovës” Sh.A.:

- Drejtoria e Përkrahjes;
- Drejtoria e Shërbimeve Postare;
- Drejtoria e Zhvillimit të Biznesit dhe
- Drejtoria e Financave, e cila do të udhëhiqet nga ZKFTH.

Në vijim është paraqitur Struktura Organizative e re e NPQ “Posta e Kosovës” Sh.A. (niveli i parë).

Figura 2: Struktura Organizative e re e PK Sh.A.



Fjala e Kryesuesit të BD

I nderuar Aksionar,

Posta e Kosovës ka kaluar një vit të rëndësishëm, të përcjellur me angazhime dhe përpjekje të vazhdueshme për të përmirësuar shërbimet e ofruara dhe për t'u përballur me sfidat e sektorit postar.

Në këtë periudhë, Bordi i Drejtorëve, ka përqendruar angazhimin e tij në ekzekutimin e detyrave të lejuara nga legjislacioni dhe aktet e brendshme të ndërmarrjes, me qëllim të arritjes së planifikimeve të parashikuara për ndërmarrjen. Kështu, Bordi ka luajtur një rol aktiv dhe ka përkrahur menaxhmentin duke ofruar mbështetje dhe mbikëqyrje për të siguruar që çdo hap të jetë në përputhje me misionin tonë për ofrimin e shërbimeve cilësore dhe të qëndrueshme.



Pas 12 vitesh, prej se operon si entitet i vetëm, është hera e parë që Posta e Kosovës përmbyll vitin financiar me performancë pozitive, arritje e cila konfirmon angazhimin e menaxhmentit dhe punëtorëve të ndërmarrjes për të ofruar shërbime cilësore dhe menaxhim efikas te operacioneve, ndërsa, pasqyron planifikimin dhe udhëheqjen e duhur të Bordit aktual të drejtorëve, që gjatë mandatit të tij ka arritur të përmbush disa nga objektivat strategjike të ndërmarrjes.

Ky vit ka kërkuar gjithashtu një përqendrim të veçantë në ristrukturimin dhe optimizimin e proceseve, me qëllim që të rrisim efikasitetin dhe të mund të përballojmë më mirë kërkesat e konsumatorëve dhe tregut në rritje.

Një nga sfidat kryesore ka qenë mbulimi i shërbimit universal postar. Kërkesa për shërbime postare tradicionale ka rënë ndjeshëm, gjë që ka bërë më të vështirë ruajtjen e një niveli të qëndrueshëm të shërbimeve. Megjithatë, duke e kuptuar rëndësinë që kanë këto shërbime për qytetarët, për herë të parë jemi kompensuar nga ministria e linjës për ofrimin e shërbimit universal për të mbuluar diferencën midis kostove dhe të ardhurave. Një arritje e tillë, vie si rezultat i angazhimit të Bordit të Drejtorëve dhe menaxhmentit të ndërmarrjes për të përmbushur kërkesat ligjore të raportimit financiar konform rregulloreve 52 dhe 53 të ARKEP dhe Ligjit për shërbimet postare. Kjo ka mundësuar që Posta e Kosovës të vazhdojë të ofrojë shërbime për qytetarët, pa e rrezikuar stabilitetin financiar të ndërmarrjes.

Në përpjekje për të adresuar sfidat dhe për të siguruar një të ardhme të qëndrueshme, kemi investuar në përmirësimin e kapaciteteve infrastrukturore dhe operacionale. Këto investime kanë për qëllim rritjen e efikasitetit dhe përmirësimin e shërbimeve që ofrojmë për konsumatorët. Procesi i ristrukturimit është ende në zhvillim dhe pritet të përfundojë gjatë vitit 2025, ndërsa qëllimi është krijimi i një strukture më fleksibile, që mund të përballojë nevojat e tregut dhe të sigurojë menaxhim më të efektshëm të burimeve.

Viti 2024 ka qenë një periudhë e rëndësishme për Postën e Kosovës. Me angazhimin për të ofruar shërbime cilësore dhe inovative, ne kemi arritur të përparojmë në disa fusha dhe të sigurojmë një pozicion më të fortë për të përballuar sfidat e ardhshme. Me një strukturë të riorganizuar dhe mbështetje të qëndrueshme, Posta e Kosovës është plotësisht e gatshme dhe e orientuar në ofrimin e shërbimeve sa më cilësore për konsumatorët.

Gëzim Paci

Kryesues i Bordit të Drejtorëve



Fjala e Kryeshefes Ekzekutive

Viti 2024 shënoi një moment historik për Postën e Kosovës, duke konfirmuar suksesin e strategjisë sonë të rimëkëmbjes dhe modernizimit. Për herë të parë që nga ndarja nga Telekom i Kosovës në vitin 2012, kemi arritur një rezultat financiar pozitiv, një arritje që reflekton përkushtimin dhe vizionin tonë për të ndërtuar një ndërmarrje të qëndrueshme, konkurruese dhe të orientuar drejt së ardhmes. Ky sukses nuk është thjesht një tregues financiar, por një dëshmi e qartë e transformimit tonë thelbësor, ku çdo vendim dhe çdo investim ka pasur në fokus krijimin e një Poste më efikase, më inovative dhe më pranë qytetarëve dhe bizneseve të Kosovës.



Në një ambient gjithnjë e më sfidues, kemi dëshmuar se përmes menaxhimit të përgjegjshëm dhe një qasjeje strategjike, Posta e Kosovës mund të jetë një model i qëndrueshmërisë dhe inovacionit. Ristrukturimi organizativ ka optimizuar burimet dhe ka rritur efikasitetin, ndërkohë që investimet në digjitalizim dhe modernizim kanë përmirësuar cilësinë dhe shpejtësinë e shërbimeve tona. Mbështetja e qeverisë për Shërbimin Universal Postar ka sjellë një model operimi më të qëndrueshëm, ndërsa angazhimi ynë për të eliminuar borxhet e vjetra dhe për të përmirësuar likuiditetin ka krijuar një bazë solide për rritje të mëtejshme. Për më tepër, këtë e ka konfirmuar edhe auditori i jashtëm, duke vlerësuar përparimin tonë në përmbushjen e standardeve të transparencës dhe përgjegjësisë financiare, si pasqyrë e menaxhimit tonë të shëndoshë dhe të përgjegjshëm.

Rritja prej 11% në zyra postare në vitin 2024, duke arritur në total 152 zyra postare anë e kënd Kosovës, ka garantuar një qasje më të gjerë dhe një shërbim më të afërt për qytetarët. Përmirësimet në infrastrukturë, duke përfshirë investimet në flotën ekologjike me motoçikleta elektrike dhe furgonë modernë, kanë rritur cilësinë dhe qëndrueshmërinë e operacioneve tona, duke ulur njëkohësisht edhe kostot operative. Kemi bërë hapa të rëndësishëm në digjitalizimin e proceseve dhe automatizimin e shërbimeve, duke e pozicionuar Postën e Kosovës si një ofrues modern dhe efikas të shërbimeve postare dhe financiare jo bankare.

Ky sukses nuk është rastësi. Ai është rezultat i përkushtimit të një ekipi të palodhshëm profesionistësh, i mbështetjes së klientëve tanë besnikë dhe i një bashkëpunimi të fortë me partnerët tanë strategjikë. Në vitet në vijim synojmë ta thellojmë këtë transformim, duke forcuar pozicionin e Postës së Kosovës si një aktor kyç në tregun e shërbimeve postare dhe financiare jo bankare. Do të vazhdojmë të investojmë në modernizim, të zgjerojmë rrjetin tonë dhe të zhvillojmë shërbime të reja që u përgjigjen nevojave të tregut dhe qytetarëve tanë. Duke reflektuar mbi rrugëtimin tonë deri më tani, është e qartë se e ardhmja e Postës së Kosovës është më e ndritur se kurrë. Jemi të bindur se përmes inovacionit, përkushtimit dhe vizionit të qartë, do të vazhdojmë të rritemi dhe të forcojmë pozitën tonë si një institucion kyç në shërbimin ndaj qytetarëve dhe bizneseve të Kosovës. Në këtë rrugëtim, mbështetja juaj mbetet shtylla kryesore e suksesit tonë. Me optimizëm dhe vendosmëri, do të vazhdojmë të ndërtojmë një Postë moderne, të qëndrueshme dhe të orientuar nga e ardhmja.


Nora Rraci
Kryeshefe Ekzekutive e PK Sh.A.



Zhvillimi i qëndrueshëm

Si institucion me një histori të gjatë shërbimi ndaj qytetarëve, Posta e Kosovës vazhdon të jetë një partner i besueshëm në mbështetjen e kauzave të rëndësishme, duke kontribuar në zhvillimin e një shoqërie më të ndërgjegjshme, të drejtë dhe të barabartë për të gjithë.

Posta e Kosovës është duke marrë një rol aktiv në nxitjen e programeve të përgjegjësisë sociale duke marrë hapa konkret si në vijim:



Flota Elektrike

Ulja e ndikimit mjedisor të flotës mbetet një prioritet për sektorin postar. Posta e Kosovës është e përkushtuar të transformojë gradualisht flotën e saj në elektrike. Me fonde vetanake, Posta ka pasuruar flotën me 59 motoçikleta elektrike, duke përmirësuar shërbimin e dërgesave për konsumatorët dhe njëkohësisht kontribuar në mbrojtjen e mjedisit. Ky investim në motorikë moderne ka krijuar kushte më të mira për postierët, duke mundësuar shpërndarje më efikase të dërgesave në të gjitha vendbanimet e Republikës së Kosovës.

Në kuadër të këtij angazhimi, Posta e Kosovës ka investuar në vitin 2024 në blerjen e shtatë furgonëve të rinj postarë. Posta mbetet e përkushtuar të zhvillojë projekte me efekt të dyfishtë: përmirësimin e cilësisë së shërbimit dhe reduktimin e emetimit të karbonit.

Efiçienca e Energjisë

Posta e Kosovës Sh.A. ka realizuar investime të rëndësishme për përmirësimin e efiçencës së energjisë në objektet e saj. Janë ndërmarrë punime për izolimin e çatave, dyerve dhe dritareve, duke përmirësuar mbajtjen e temperaturës dhe kursyer konsumin e energjisë.

Gjithashtu, është bërë ndërrimi i ndriçimit të vjetër me ndriçim LED më efikas, duke ulur kostot e energjisë dhe rritur cilësinë e ndriçimit. Në kuadër të këtyre përmirësimeve, Posta ka zëvendësuar klimatizuesit klasikë me

inverter, të cilët ofrojnë kursim më të madh të energjisë dhe efikasitet më të lartë në ngrohje dhe ftohje, duke përmirësuar gjithashtu komfortin për punonjësit dhe konsumatorët.

Po ashtu, janë hapur zyra të reja me koncept ekologjik, të projektuara për të siguruar kushte më të mira pune dhe për të ulur ndikimin mjedisor. Këto zyra janë pajisur me materiale të qëndrueshme dhe sisteme të mençura të menaxhimit të energjisë, duke krijuar një mjedis më funksional dhe miqësor ndaj mjedisit.

Në vijim të investimeve për përmirësimin e infrastrukturës teknologjike, Posta e Kosovës ka zëvendësuar kompjuterët e vjetër me kompjuterë të rinj dhe më të fuqishëm. Kjo ka sjellë përmirësime të ndjeshme në performancën e sistemeve operative dhe shpejtësinë e përpunimit të të dhënave, duke lehtësuar punën e stafit dhe duke rritur efikasitetin në ofrimin e shërbimeve për konsumatorët. Kompjuterët e rinj janë të pajisur me teknologji moderne dhe konsum më të ulët të energjisë, duke kontribuar në uljen e ndikimit mjedisor dhe rritjen e produktivitetit të përgjithshëm.

Elemente Ekologjike në Projekte

Posta e Kosovës tregon kujdes të veçantë për përfshirjen e elementeve ekologjike në të gjitha projektet e saj. Në projektet infrastrukturore, Posta siguron përdorimin e materialeve miqësore ndaj mjedisit, instalimin e sistemeve të mençura për kursimin e energjisë dhe krijimin e hapësirave të gjelbra. Po ashtu, në procesin e digjitalizimit, Posta synon të zvogëlojë konsumin e letrës dhe mbetjeve, duke promovuar zgjidhje digjitale dhe qëndrueshmëri afatgjatë.

Kjo qasje e integruar ndaj qëndrueshmërisë dhe përfshirja e praktikave ekologjike në operacionet e përditshme reflekton angazhimin e Postës së Kosovës për të kontribuar në mbrojtjen e mjedisit dhe zhvillimin e qëndrueshëm.

Përkrahja e kauzave sociale: Posta e Kosovës është e angazhuar në mbështetjen e kauzave të rëndësishme si pjesë e përgjegjësisë tonë sociale nëpërmjet lansimit të emisioneve të pullave postare si "Mbrojtja e Ambientit" dhe emisioni kundër dhunës gjinore "Sot dhe çdo ditë tjetër".

Njëkohësisht të angazhuar në mbështetjen dhe përkrahjen e çdo fushate dhe iniciative në dobi të qytetarëve nëpërmjet publikimit të mesazheve përkrahëse në platformat online si dhe në rrjetin e gjerë të zyrave postare.

Një aspekt i veçantë i angazhimit tonë social është puna me fëmijët, duke organizuar aktivitete edukuese dhe kreative që lidhen me historinë e pullës postare, rëndësinë e komunikimit përmes letrave dhe mesazheve, si dhe ndërgjegjësimin për çështje të ndryshme shoqërore. Përmes këtyre aktiviteteve, synojmë të frymëzojmë brezat e rinj dhe të kultivojmë tek ata vlera si solidariteti, kujdesi për ambientin dhe barazia sociale.



Bordi i Drejtorëve

Bordi i Drejtorëve i Postës së Kosovës, në emër të Aksionarit, ka ushtruar kompetencat e veta në përmbushjen e obligimeve dhe detyrave të veta, duke hartuar politika dhe dokumente tjera strategjike për ndërmarrjen.

Në funksion të përmbushjes së detyrave të veta, Bordi i Drejtorëve i PK-së, në vazhdimësi ka monitoruar zhvillimet në kompani, duke i krahasuar ato me objektivat e përcaktuara me Planin e Biznesit dhe dokumentet tjera.

Gjatë vitit 2024, NPQ "Posta e Kosovës" Sh.A. ka funksionuar me Bordin e Drejtorëve të emëruar me vendim të Qeverisë së Republikës së Kosovës me nr. 06/56, të datës 26.01.2022.

Gjatë kësaj periudhe, Bordi i Drejtorëve, në emër të Aksionarit ka ushtruar kompetencat e veta, me qëllim të përmbushjes së detyrave dhe obligimeve ligjore që dalin nga legjislacioni i aplikueshëm për NP-të.

Aktivitetet dhe performanca e ndërmarrjes

Në Raportin Vjetor të Postës së Kosovës Sh.A. për vitin 2024 pasqyrohen të dhënat për performancën e ndërmarrjes, të arriturat si dhe sfidat me të cilat ndërmarrja është ballafaquar. Për dallim nga vitet e tjera (nga momenti i ndarjes nga PTK-ja në vitin 2012) kur Posta e Kosovës ka pasur humbje të vazhdueshme financiare, në vitin raportues PK ka arritur bilanc pozitiv.

Përkundër rënies së të hyrave nga ndërprerja e kontratës për shpërndarjen e skemave sociale me vendim të Ministrisë së Financave, Punës dhe Transfereve (MFPT) dhe uljes së të hyrave nga kontrata për qiradhënie me Telekomin, Posta e Kosovës ka arritur që ta përfundojë vitin fiskal 2024 me fitim prej 286, 472 euro.

Përveç arritjeve të suksesshme në ngritjen e të hyrave nga disa shërbime/produkte, PK për herë të parë është kompensuar për ofrimin e Shërbimit Universal Postar nga ana e Aksionarit.

Aktivitetet kryesore të ndërmarrjes gjatë vitit 2024

Përkushtimi kryesor i Postës së Kosovës gjatë vitit 2024 ka qenë përmbushja e kërkesave të konsumatorëve për shërbimet që ofrohen nga ana e kompanisë, siç janë: shërbimet postare (me theks të veçantë me persona juridik), shërbimet e IFJB-së, shërbimet e Telekomit, etj.

Të hyrat më të mëdha edhe gjatë vitit 2024 kanë qenë të hyrat nga qiraja, të cilat janë 36% e të hyrave totale. Pasonjë te hyrat nga kategoria "Konsumatorët e mëdhenj", të cilat janë rritur për 13% krahasuar me vitin paraprak, respektivisht 7% krahasuar me PB. Te hyrat nga kjo kategori marrin pjesë me 22% në të hyrat totale nga veprimtaria.

Vlen të theksohet se ka pasur ngritje të të hyrave për 5% krahasuar me vitin 2023 edhe në kategorinë e të hyrave nga shërbimet e IFJB-së.

E arritur që vlen gjithsesi të ceket është aprovimi i kërkesës për kompensim të humbjeve të shkaktuara nga ofrimi i SHUP në vlerë prej 1,168,932.00 €, nga ana e ARKEP. Kjo është arritur falë angazhimit të Menaxhmentit që e ka përgatitur Rregulloren për procedurat e llogaritjes së të hyrave dhe kostove të humbjeve nga ofrimi i SHUP, ka angazhuar auditorin e jashtëm për auditim të Raportit të PF për SHUP. Po ashtu, paraprakisht ka qenë e domosdoshme edhe ndarja kontabël e kostove për këtë shërbim të veçantë.

Gjatë vitit 2024 është bërë zgjerimi i zyrave postare (17) nëpër institucione të ndryshme për kryerjen e shërbimeve financiare jo bankare dhe shërbimeve tjera, ndërsa me qëllim të reduktimit të shpenzimeve, zyrat postare që kanë afaruar me humbje janë mbyllur. Janë bërë rregullime në infrastrukturën ligjore, përkatësisht

është bërë hartimi dhe plotësim/ndryshimi i rregulloreve të domosdoshme për funksionimin normal dhe efikas të Postës.

Pasqyra e performancës operative dhe financiare në krahasim me vitin paraprak dhe planifikimin e vitit aktual

Posta e Kosovës Sh.A. sipas Planit të Biznesit të aprovuar nga BD, gjatë vitit fiskal 2024 ka planifikuar gjithsej 10,503,060 euro të hyra nga veprimtaria, si dhe 1,327,252€ të hyra për kompensim të SHUP-it. Gjatë kësaj periudhe janë realizuar gjithsej 10,416,745€ të hyra, me një diferencë negative prej 86,315 euro apo -1% realizim më të ulët se planifikimi. Krahasuar me vitin paraprak, të hyrat janë më të larta për 4% apo në vlerë financiare 353,415€ më shumë. Ndikimi më i madh në mos arritjen e të hyrave të planifikuara ka qenë nga ulja e vëllimit fizik të dërgesave postare të regjistruara “e-commerce” me origjinë nga Kina, nga platforma e blerjeve online “Aliexpress”, që ka ardhur si rezultat i devijimit të kanaleve të transportit përmes operatorëve publik postarë.

Për vitin 2024 Posta pret të kompensohet për kostot e shkaktuara për ofrimin e SHUP-it, gjithnjë duke u bazuar në vitin paraprak kur ka realizuar një kompensim të tillë. Vlera e llogaritur për kompensim për SHUP për vitin aktual është mbi 1.2 milion euro.

Gjatë vitit 2024, ndërmarrja i ka kushtuar rëndësi të veçantë edhe uljes së shpenzimeve operative. Krahasuar me vitin 2023, shpenzimet operative (përfshirë edhe shpenzimet e personelit) janë më të ulëta për 3% (269,441€), ndërsa krahasuar me Planin e Biznesit janë më të ulëta për 9% (965.375€).

Ngjarjet të cilat ndikojnë në të ardhmen e ndërmarrjes

Po ashtu, edhe këtë vit mbeten sfidat e njëjta sikurse vitet paraprake: likuiditeti i ndërmarrjes, mos përmbyllja e plotë e strukturës organizative, infrastruktura dhe asetet fikse të vjetruara, mosdhënia e shërbimeve shtetërore nga ana e disa ministrive, për të cilat nevojitet gatishmëria e Qeverisë për t'i kryer këto obligime dhe për të marrë vendime që Posta e Kosovës t'i kryejë shërbimet shtetërore. Gjithashtu, edhe konkurrenca e ashpër nga operatorë privat vazhdon të jetë një sfidë e madhe në ofrimin e shërbimit “Blerjet online”. Edhe përkundër angazhimit të madh që ka pasur Bordi dhe Menaxhmenti për këto shërbime, angazhimi duhet të vazhdojë dhe investimet në logjistik.

Të priturat për vitin e ardhshëm

Me hyrjen në fuqi të Rregullores për kalkulim të humbjeve të krijuara gjatë ofrimit të Shërbimit Universal Postar, edhe për këtë vit pritet të bëhet kompensimi nga ana e Qeverisë së Republikës së Kosovës për Shërbimin Universal, si dhe arritja e dakordimeve për mbulim të shpenzimeve të deritanishme. Kompensimi i humbjeve gjatë ofrimit të këtij shërbimi do të krijojë mundësi investive dhe ngritje të shërbimeve në nivele konkurrencte. Pritet të bëhet zgjerimi i digjitalizimit të Postës së Kosovës, në mënyrë që të arrihet një nivel i njëjtë me postat në regjion dhe më gjerë.

Informacione lidhur me kapitalin dhe dividendën

Kapitali themeltar i Postës së Kosovës është në shumën prej 525,000, ndërsa sa i përket dividendës, Posta e Kosovës është duke operuar me një fitim minimal (qysh nga ndarja me Telekomini në vitin 2012) dhe nuk mund të ndajë dividendë.

Të dhënat për drejtorët jo ekzekutiv

Në pajtim me nenin 15 të Ligjit 03/L-87 për Ndërmarrjet Publike, Aksionari, në këtë rast Qeveria e Republikës së Kosovës, emëron dhe shkarkon anëtarët e bordeve të ndërmarrjeve publike qendrore. Mbi këtë bazë, më 26.01.2022, me vendimin nr. 06/56, është emëruar Bordi i Drejtorëve i Postës së Kosovës Sh.A.

Më datë 15.01.2024, me vendimin nr. 01/184, ndryshohet dhe plotësohet vendimi i Qeverisë nr. 06/56 i datës 26.01.2022 (me rastin e dorëheqjes së Z. Fadil Bejta) dhe Kryesuese e Bordit të Drejtorëve emërohet Znj. Hyrmet Mydyti.

Më datë 23.09.2024, me vendimin nr. 01/221, ndryshohet dhe plotësohet vendimi nr. 01/184 i datës 15.01.2024 dhe në vend të Znj. Hyrmet Mydyti, Kryesues i Bordit emërohet Z. Gëzim Paci, ndërsa Znj. Hyrmet Mydyti emërohet anëtare e Bordit të Drejtorëve të ndërmarrjes publike qendrore “Posta e Kosovës” Sh.A., me përbërje sipas tabelës nr. 1 në vijim.

Bordi i Drejtorëve, gjatë vitit 2024 ka mbajtur gjithsej 20 takime, prej tyre 15 takime të rregullta dhe 5 takime të jashtëzakonshme.

Tabela 1: Bordi i Drejtorëve

Nr.	Emri dhe Mbiemri	Pozita	Pjesëmarrja në takime/mbledhje
1	Gëzim Paci	Kryesues	20
2	Safija Beseni	Anëtare	18
3	Sebahate Krasniqi	Anëtare	18
4	Visar Nura	Anëtar	20
5	Hyrmet Mydyti	Anëtare	20
6	Nora Rraci	Anëtare e BD-së nga pozita e Kryeshefes Ekzekutive	18
7	Florent Tahiraj	Sekretar/Këshilltar i Përgjithshëm Korporativ	20

Tabela 2: Statistika nga aktiviteti i Bordit të Drejtorëve për vitin 2024

Bordi Drejtorëve	Data	Vendime	Rekomandime	Përmbledhje	Lloji i takimit	Total veprimet
Takimi nr. 1	18.01.2024	7	1	0	Rregullt	8
Takimi nr. 2	02.02.2024	6	0	1	Rregullt	7
Takimi nr. 3	23.02.2024	1	0	0	Jashtëzakonshëm	1
Takimi nr. 4	27.02.2024	5	0	1	Rregullt	6
Takimi nr. 5	14.03.2024	5	0	1	Rregullt	6
Takimi nr. 6	28.03.2024	2	0	0	Jashtëzakonshëm	2
Takimi nr. 7	25.04.2024	9	1	1	Rregullt	11
Takimi nr. 8	29.04.2024	3	0	0	Rregullt	3
Takimi nr. 9	14.05.2024	3	0	1	Jashtëzakonshëm	4
Takimi nr.10 Kuvendi Vjetor i Aksionarëve	25.05.2024	3	0	0	Rregullt	3
Takimi nr. 11	29.05.2024	4	0	1	Rregullt	5
Takimi nr. 12	12.06.2024	1	0	0	Jashtëzakonshëm	1
Takimi nr. 13	18.03.2024	3	0	1	Rregullt	4
Takimi nr. 14	30.07.2024	4	1	1	Rregullt	6
Takimi nr. 15	29.08.2024	2	0	1	Rregullt	3
Takimi nr. 16	03.10.2024	6	1	1	Rregullt	8
Takimi nr. 17	25.10.2024	6	0	1	Rregullt	7
Takimi nr. 18	08.11.2024	1	0	0	Jashtëzakonshëm	1
Takimi nr. 19	25.11.2024	7	1	1	Rregullt	9
Takimi nr. 20	24.12.2024	8	0	1	Rregullt	9
Gjithsej takime	Gjithsej vendime		Gjithsej rekomandime	Gjithsej përmbledhje	Takime të rregullta	Takime të jashtëzakonshme
20	87		5	13	15	5

Komisioni i Auditimit, i cili si komision funksional është themeluar sipas Ligjit për Ndërmarrje Publike dhe i cili shqyrton parametrat financiare të afarizmit, gjatë vitit 2024 ka mbajtur gjithsej 13 mbledhje, prej tyre 9 të rregullta dhe 1 mbledhje të jashtëzakonshme. Në tabelat në vijim paraqitet përbërja e Komisionit të Auditimit, i cili ka vepruar gjatë vitit 2024 dhe pjesëmarrja e anëtarëve në mbledhje.

Në vijim, në formë tabelore janë paraqitur të dhënat lidhur me anëtarët e Komisionit të Auditimit, si dhe aktivitetet e tyre të realizuara gjatë periudhës janar - dhjetor 2024.

Tabela 3: Komisioni Auditimit

Nr.	Emri dhe Mbiemri	Pozita	Pjesëmarrja në mbledhje
1	Safija Beseni	Kryesuese	13
2	Sebahate Krasniqi	Anëtare	12
3	Visar Nura	Anëtar	13

Tabela 4: Statistika nga aktiviteti i Komisionit të Auditimit për vitin 2024

Komisioni i Auditimit	Data	Vendime	Rekomandime	Përmbledhje	Lloji i takimit	Total veprime
Takimi nr. 1	20.02.2024	2	2	0	Rregullt	4
Takimi nr. 2	13.03.2024	1	1	0	Rregullt	2
Takimi nr. 3	27.03.2024	2	1	0	Rregullt	3
Takimi nr. 4	29.04.2024	1	2	0	Rregullt	3
Takimi nr. 5	15.05.2024	2	1	0	Rregullt	3
Takimi nr. 6	01.07.2024	1	2	0	Rregullt	3
Takimi nr. 7	26.07.2024	1	1	0	Jashtëzakonshëm	2
Takimi nr. 8	15.08.2024	3	3	0	Rregullt	6
Takimi nr. 9	21.10.2024	3	1	0	Rregullt	4
Takimi nr. 10	25.10.2024	0	1	0	Jashtëzakonshëm	1
Takimi nr. 11	07.11.2024	0	1	0	Jashtëzakonshëm	1
Takimi nr. 12	22.11.2024	0	1	0	Jashtëzakonshëm	1
Takimi nr. 13	18.12.2024	1	0	0	Rregullt	1
Gjithsej takime	Gjithsej vendime		Gjithsej rekomandime	Gjithsej përmbledhje	Takime të rregullta	Takime të jashtëzakonshme
13	17		17	0	9	4

Ngjarjet kryesore të vitit 2024

Drejtoria e Përkrahjes - DP

Drejtoria e Përkrahjes (DP) operon në kuadër të PK Sh.A., si rezultat i ristrukturimit të zbatuar që nga data 01.10.2024. Gjatë vitit 2024, Drejtoria e Përkrahjes ka luajtur një rol kyç në racionalizimin e proceseve dhe menaxhimin strategjik të burimeve, me fokus në rritjen e efikasitetit dhe reduktimin e shpenzimeve. Përmes modernizimit të infrastrukturës, investimeve në efikasitet, përmirësimit të shërbimeve mbështetëse dhe implementimit të politikave të kursimit, janë arritur rezultate të matshme në mirëmbajtjen e objekteve, transportin, menaxhimin e burimeve njerëzore dhe sigurinë teknologjike. Gjithashtu, në raport është paraqitur një analizë e hollësishme e ndikimit të këtyre masave dhe synimeve për përmirësim të vazhdueshëm në vitet në vijim.

Ndryshimet organizative të Drejtorisë së Përkrahjes:

Kjo drejtori është krijuar nga bashkimi i tri drejtorive, respektivisht disa departamenteve kryesore:

- Departamenti i Administratës
- Departamenti i Resurseve Njerëzore
- Departamenti për Çështje Ligjore
- Departamenti Teknologjisë Informativë.

Rezultatet dhe ndikimi gjatë vitit 2024:

Përgjatë vitit 2024, ndryshimet organizative të implementuara nga Drejtoria e Përkrahjes kanë krijuar një ndikim pozitiv në përmirësimin e efikasitetit të punës dhe harmonizimin e funksioneve mbështetëse, i cili ka përfshirë:


- Rritje të efektivitetit të menaxhimit të burimeve njerëzore përmes trajnimeve dhe zhvillimit të kapaciteteve të stafit.
- Përmirësim të shërbimeve ligjore përmes harmonizimit të politikave të brendshme me legjislacionin në fuqi.
- Mbështetje teknologjike më të avancuar përmes mirëmbajtjes dhe modernizimit të infrastrukturës së TI-së.
- Administratë më të organizuar, duke mundësuar zbatimin e proceseve të thjeshtësuara dhe të koordinuara.

Departamenti i Administratës

Gjatë periudhës janar-dhjetor 2024, nga fusha e transportit, logjistikës, mirëmbajtjes dhe sigurimit të objekteve janë realizuar këto aktivitete:

- Menaxhimi i automjeteve të PK-së, përfshirë mirëmbajtjen, mbikëqyrjen dhe raportimin e shpenzimeve, si dhe regjistrimin, sigurimin, kontrollin teknik, monitorimin me GPS dhe këmbimin e dërgesave postare me regjione, më Maqedoninë e Veriut dhe Shqipërinë, si dhe me institucionet bankare e mikrofinanciare.
- Furnizimi me vetura të reja për transportin e dërgesave postare.
- Mirëmbajtja e përgjithshme e objekteve, duke përfshirë instalimet elektrike, gjeneratorët, ngrohjen qendrore, instalimet hidrosanitare, riparimet e dyerve, dritareve dhe inventarit, si dhe përcjellja e shërbimeve komunale. Janë përgatitur paramasa, specifikime teknike dhe janë iniciuar kërkesa për lidhje të kontratave.
- Pranimi dhe shpërndarja e mallrave nga depoja qendrore tek regjionet dhe administrata, sipas kërkesave të drejtorive të PK-së, bazuar në kontrata dhe urdhër blerje.
- Caktimi dhe pjesëmarrja e stafit në komisione vlerësimi, sipas kërkesës së Drejtorisë së Prokurimit.
- Përgatitja e projekteve kapitale dhe shpenzimeve operative për planifikimin dhe rishikimin e buxhetit 2024 dhe PB 2025/27, si dhe përgatitja/dhënia e arsyeshmërive për ndarjet buxhetore.


Figura 3: Krahasimi i shpenzimeve të derivateve për vitin 2024 me vitin 2023



Shënim: Në kategorinë e shpenzimeve të derivateve për transport, gjatë vitit 2023 janë shpenzuar 154,156 euro, ndërsa gjatë vitit 2024 kjo shifër ka rënë në 139,510 euro. Krahasuar me vitin 2023, shpenzimet janë ulur për 14,645 euro, apo për 9.5 % më pak.

Faktori kryesor që ka ndikuar në uljen e shpenzimeve në këtë kategori është mirëmbajtja e automjeteve dhe investimi në 59 motoçikleta për postierët. Ky investim ka rritur efikasitetin në shpërndarjen e postës, duke reduktuar përdorimin e automjeteve me konsum më të lartë të karburantit. Si rezultat i kësaj, janë ulur ndjeshëm shpenzimet për karburante, duke kontribuar në menaxhimin më të mirë të burimeve financiare.

Figura 4: Krahasimi i shpenzimeve komunale për vitin 2024 me vitin 2023



Shënim: Në kategorinë e shpenzimeve publike, gjatë vitit 2023 janë shpenzuar 191,929 euro, ndërsa gjatë vitit 2024 kjo shifër ka rënë në 178,754 euro. Krahasuar me vitin 2023, shpenzimet janë ulur për 13,175 euro, apo për 6.8 % më pak.

Faktori kryesor që ka ndikuar në uljen e shpenzimeve në këtë kategori është investimi i duhur në pajisje të klimatizimit me teknologji inverter (klasë energjetike A++), të cilat janë efijente dhe me konsum të ulët energjetik.

komunale për vitin 2024 me vitin 2023

Departamenti i Resurseve Njerëzore

Rekrutime

Përmbledhje e procesit të rekrutimit për vitin 2024

Në vitin 2024, PK Sh.A. ka ndërmarrë hapa të rëndësishëm për plotësimin e nevojave me staf, përkundër sfidave financiare, rritjes së shërbimeve dhe largimeve nga puna, duke përfshirë ndërprerjen e marrëdhënies së punës me vetë dëshirë. Në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe rekomandimet e Inspektoratit të Punës, janë zhvilluar procedura transparente dhe të rregullta të rekrutimit.

Konkurse publike (konkurse të brendshme dhe konkurse të jashtme)

Fillimisht janë shpallur konkurse të brendshme, të cilat nuk kanë arritur sukses në përzgjedhjen e kandidatëve të duhur.

Në vijim, janë shpallur konkurse të jashtme për plotësimin e vendeve të lira, bazuar në legjislacionin në fuqi.

Përmbledhje statistikore për vitin 2024

- Punonjës të rinj: 64;
- Ndërrim jete: 5;
- Suspendime: 9;
- Ndërprerje e marrëdhënies së punës sipas vendimit të Komisionit Disiplinor: 21;
- Ndërprerje e marrëdhënies së punës me vetë dëshirë: 30;
- Ndërprerje e marrëdhënies së punës sipas dispozitave ligjore nga BD për ZKFTH: 1;
- Pensionime: 28.

Procesi i menaxhimit të performancës

Gjatë vitit 2024, procesi i menaxhimit të performancës është realizuar dy herë dhe atë në përputhje me rregulloren në fuqi të PK Sh.A.

Struktura e të punësuarve në PK Sh.A.

Tabela 5: Struktura e të punësuarve në PK Sh.A. sipas gjinisë

Gjinia e punonjësve	01.01.2024	31.12.2024
Femra	227	249
Meshkuj	693	634
Gjithsej	920	883

Trajnimet dhe zhvillimi

Vëmendje e veçantë gjatë vitit 2024 i është kushtuar trajnimit të stafit dhe atë duke zhvilluar dhe zbatuar trajnime në fusha të ndryshme, me fokus trajnimet për punonjësit që lidhen drejtpërdrejt me shërbimet postare dhe kujdesin ndaj konsumatorit, siç janë postierët dhe stafi i sporteleve, por jo vetëm. Në vijim po veçojmë disa prej trajnimeve të organizuara gjatë kësaj periudhe:

- Trajnimi në modulin: Shërbime Postare Vendore dhe Ndërkombëtare me gjithsej 22 punonjës të trajnuar.
- Trajnimi në modulin: Shërbim ndaj Konsumatorit, Shërbime Postare dhe Operative dhe SASP, me gjithsej 27 punonjës të trajnuar.
- Trajnimet lidhur me pranimin e kërkesave për ASHAK (Agjencia Shtetërore e Arkivave të Kosovës), me gjithsej 59 punonjës të trajnuar.
- Trajnimi në modulin: Hartimi i Raporteve dhe Menaxhimi i Kontratave, me gjithsej 13 punonjës të trajnuar.

Gjithashtu, gjatë periudhës janar – dhjetor 2024, 5 punonjës kanë mbajtur trajnime të kontraktuara sipas fushave:

- Prokurim (KRPP),

- Instituti për Kontabilitet, Auditim e Financa/ Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar (SNK/SNRF) dhe zbatimi i tyre në tatimin për të ardhurat dhe kontratat me klientë.
- Instituti për Kontabilitet, Auditim e Financa/ Shkrimi Cilësor në Auditim.
- Instituti i Kosovës për Administratë Publike/ Auditimi i Performancës.
- Workshop në eventin Cisco Connect.

Përmes trajnimeve të lartcekura është arritur që një numër prej 121 punonjësish të marrin njohuri të reja profesionale, gjë që ka ndihmuar në përmirësimin e aftësive dhe njohurive të punonjësve, duke siguruar shërbime më cilësore dhe përkujdesje më të lartë ndaj kërkesave të konsumatorëve.

Menaxhmenti i Postës së Kosovës do të angazhohet edhe në të ardhmen për organizimin e trajnimeve në fusha të ndryshme që rrisin performancën e punonjësve dhe kapacitetet e brendshme të ndërmarrjes, për të qenë më transparentë dhe sa më efikas në ofrimin e shërbimeve ndaj qytetarëve.

Departamenti për Çështje Ligjore

Ndër objektivat kryesore të Departamentit Ligjor të PK-së është mbështetja e aktiviteteve të ndërmarrjes nga perspektiva ligjore. Për të arritur këtë qëllim, Departamenti Ligjor ka për detyrë të mbrojë interesat e Postës së Kosovës Sh. A., si dhe të sigurojë mbrojtje të suksesshme në të gjitha aspektet e veprimtarisë së saj.

Departamenti Ligjor (DL) ka përgjegjësi për hartimin e vendimeve dhe politikave strategjike të biznesit të Postës së Kosovës dhe për menaxhimin e të gjitha operacioneve legale brenda ndërmarrjes. Në mënyrë të veçantë, Departamenti Ligjor përqendrohet në uljen e numrit të rasteve të kontesteve gjyqësore duke siguruar një mbrojtje ligjore sa më të mirë për Postën e Kosovës, duke i mbështetur drejtoritë dhe departamentet tjera në parandalimin e pasojave ligjore dhe financiare në vendimet e tyre, si dhe harton rregullore dhe akte tjera nënligjore, me qëllim të zbatimit të objektivave afariste që dalin nga strategjia e Postës së Kosovës.

Përmes këtij raporti prezantohet kontributi i rëndësishëm i Departamentit Ligjor në zbatimin e objektivave strategjike të Postës së Kosovës, duke përfshirë arritjen e qëllimeve ligjore dhe financiare të kompanisë, uljen e numrit të rasteve të kontesteve gjyqësore dhe mbrojtjen e afarizmit të saj nga rreziqet e humbjeve financiare.

Në vijim, është bërë përmbledhja e lëndëve gjyqësore dhe përmbartimore të realizuara gjatë vitit 2024, në të cilën PK Sh. A. është palë paditëse dhe e paditur, si dhe lëndët përmbartimore ku PK Sh. A. është Kreditor dhe Debitor.

Përmbledhja e lëndëve gjyqësore dhe përmbartimore të përfaqësuara gjatë vitit 2024:

Gjithsej 132 lëndë gjyqësore dhe përmbartimore janë të përfaqësuara nga DL gjatë vitit 2024.

Aktivitetet tjera ligjore të realizuara gjatë vitit 2024:

Gjatë vitit 2024, DL ka realizuar gjithsej 1,029 aktivitete të tjera ligjore.

Këto aktivitete kanë ndikuar në uljen e rasteve, përmirësimin e gjendjes dhe krijimin e mundësive më të mira në pasqyrimin e gjendjes së ndërmarrjes.

Departamenti i Teknologjisë Informative

Gjatë vitit 2024, përveç menaxhimit, DTI ka vazhduar edhe me uljen e shpenzimeve dhe krijimin e të hyrave të reja, duke iu përshtatur kërkesave specifike të kompanive, të cilat kanë qenë të interesuara dhe që shërbimet ia kanë besuar Postës së Kosovës.

Përveç punëve rutinë të mbikëqyrjes dhe të mirëmbajtjes së TI dhe SI, DTI ka bërë edhe zgjidhje të mundshme alternative me qëllim të kursimeve operative dhe financiare. Investimet kapitale të bëra gjatë vitit 2023 në vlerë prej 83,297.46 € dhe gjatë 2024 në vlerë prej 109,675.80 €, kanë qenë një shtytje pozitive për DTI për t'i arritur objektivat afariste në njërin anë dhe të sigurisë kibernetike në anën tjetër.

Aktivitetet kryesore të DTI-së të ndërmarra në vazhdimësi gjatë vitit 2024, me përfitimet dhe kursimet e realizuara, janë paraqitur në tabelën në vijim.

Tabela 6: Kursimet/të hyrat nga TI

Aktivitetet e ndërmarra nga DTI	Projekti/sasia	Vlera për vitin 2024
Krijimi i një (1) softueri (SW) ngrit vëllimin e dërgesave dhe të hyrave	+57442dërgesa	103,396 €
Kursimet direkte nga projektet e DTI	PEF,MSL, PPP, VPN, SW	99,487 €
Rritja e shpenzimeve	ProVPN	- 328 €
Përpunimi elektronik i dërgesave me SW e krijuar nga DTI	203995 dërgesa	12,240 €
Gjithsej të hyra 115,656 € + kursime 99,487 € - shpenzime 328 € = total		214,795 €

Shënim: Në vlerat e investimeve kapitale prej 83,297.46€ në vitin 2023 dhe 109,675.80 në vitin 2024, janë përfshirë pagesat vjetore për licencat e Microsoft-it, mirëmbajtja e 102 PEF, furnizimi me pajisje të TI & SI për 10 zyra postare të reja dhe projekti për evidentimin e ardhje/vajtjeve (access point).

Drejtoria e Shërbimeve Postare

Aktivitetet kryesore të Drejtorisë së Shërbimeve Postare gjatë vitit 2024

Gjatë vitit 2024, Drejtoria e Shërbimeve Postare ka ndërmarrë aktivitete me qëllim të realizimit të Planit Operacional dhe Planit të Biznesit, me theks të veçantë në avancimin dhe zgjerimin e gamës së produkteve dhe shërbimeve postare, shërbimeve universale postare, si dhe aktiviteteve tjera, të cilat e kanë për qëllim ngritjen e cilësisë së shërbimeve të ofruara dhe rritjen e të hyrave nga të gjitha kategoritë e shërbimeve postare.

Krahas punëve të përditshme të sortimit dhe përpunimit të dërgesave në trafikun vendor, gjatë kësaj periudhe kanë vazhduar pa ndonjë pengesë të theksuar punët operacionale për të personalizuar fajllat e pasuar me shtypjen, zarfimin, përpunimin dhe janë përgatitur për shpërndarje dërgesat postare të konsumatorëve të mëdhenj. Gjatë kësaj periudhe janë kryer të gjitha përgatitjet për të filluar së zbatuari shërbimi i ri sipas "Rregullores për procedurë doganore në trafikun postar", sipas së cilës punonjësit e Postës së Kosovës Sh.A. në cilësinë e agjentit doganor, me rastin e hyrjes së dërgesave postare në Kosovë, do të fillojnë që të përpilojnë formularin T1, do të plotësojnë Manifestin e doganës, si dhe do të përpilojnë Deklaratën Postare Doganore për të gjitha dërgesat postare, të cilat tejkalojnë pragun për doganim.

Nëse krahasojmë të dhënat e sektorëve të DSHP-së për vitin 2024, me të dhënat statistikore të vitit të kaluar (2023), vërehet se ka pasur rritje të lartë të përpunimit të dërgesave postare në Postën Vendore dhe në Postën Ndërkombëtare. Vëllimi fizik i dërgesave të përpunuara në Postën Vendore është më i lartë për 20.70%. Vëllimi fizik i dërgesave postare në Postën Ndërkombëtare është më i lartë për 11%. Deri të kjo rritje e lartë e numrit të dërgesave të përpunuara ka ardhur si rezultat i rritjes së besimit për shërbimet që ofron Posta e Kosovës për konsumatorët e saj, e që për synim ka shtimin e vëllimit të dërgesave postare të shtypura, zarfuara, përpunuara dhe shpërndara.

Ka vazhduar bashkëpunimi me Postën Shqiptare (PSH) për këmbimin e dërgesave postare ndërkombëtare në shkuarje dhe gjenerimin elektronik të mesazheve ITMATT/EDI, përdorimin e CDS nga PSH për dërgim të dërgesave postare ndërkombëtare me përmbajtje të mallrave për botën e jashtme, duke plotësuar kushtet e kërkuara për ICS2.

Gjithashtu, është bërë definimi i të hyrave nga zona e shërbimeve universale dhe shërbimeve tjera postare, si dhe barazimet për detyrimet terminale me të gjitha AP-të botërore. Është adresuar rekomandimi i auditorit dhe është në proces të zgjidhjes - mbyllja jo e plotë e qarkut në SASP.

Gjatë vitit 2024 janë analizuar alternativat për të gjetur zgjidhje për këmbimin elektronik të të dhënave dhe ndërlihdjen (interface) e SASP, me sistemet e operatorëve publik postarë për të përmirësuar sistemin e gjurmimit të dërgesave postare në ardhje, si parakusht i rritjes së bashkëpunimit me operatorët publik postarë dhe rikthimin e kanaleve për pranimin dhe shpërndarjen e dërgesave postare të regjistruara (Rekomande), në rrjetin e Postës së Kosovës.

Ka vazhduar projekti i Postës së Kosovës me DÇK/MPJD dhe ARC/MPB për pranim, bartje dhe dorëzim të dokumentacionit për shërbime të vulave Apostile dhe Legalizuese, përmes shërbimit të shpejtë postar "EMS".

Janë zhvilluar edhe aktivitete të tjera lidhur me planin e veprimit dhe punëve operacionale në QTP dhe Postën Hibride për përpunimin, shtypjen dhe zarfimin e dërgesave nga bankat komerciale, Telekomit dhe KRU "Prishtina", Ujësjellësi Regional "Hidro Drini"- Pejë dhe konsumatorët tjerë.

Tabela 7: Pasqyra vjetore e vëllimit fizik të dërgesave postare në trafikun e brendshëm -Posta Vendore 2024

Përshkrimi	Total
Kartëpostale	30
Thj. (thjeshta)	694,538
Rekomand. R	556,915
LM (Lajmërim marrje)	891,943
EMS (poste e shpejtë)	6,404
Shtypsh.	525
Pako e vogël (R)	21
Thasë M	1
Kolipostë	436
Fletëkthesa	215.934
Dërgesa online	597
Gjithsej	2,367,347

Tabela 8 : Pasqyra vjetore e vëllimit fizik të dërgesave postare në shkuarje - ardhje Posta Ndërkombëtare 2024

Përshkrimi	Total
LC/AO Letërpostë	537,387
R (rekomande)	171,802
LC online	3253
CP Koliposta	6298
Thasët "M"	60
EMS Postë e shpejtë	396
Postë korriere KCC/Fedex	1,240
Cecogam.	29
Gjithsej	720,465





posta 

**Posta e Kosovës në
çdo adresë!**

Drejtoria e Zhvillimit të Biznesit – DZHB

Drejtoria e Zhvillimit të Biznesit (DZHB), sipas strukturës organizative dhe skemës së aprovuar nga BD 01-1964-5/23, datë 18.08.2023, ka një rol kyç në zhvillimin dhe menaxhimin e shërbimeve postare dhe financiare në kuadër të Postës së Kosovës. Struktura e saj përbëhet nga tri departamente kyçe: Departamenti i Operativës, Departamenti i Shitjes, dhe Departamenti i Marketingut, Kujdesit me Konsumatorë dhe Filatelistë. Kjo strukturë mundëson menaxhimin eficient të operacioneve, të cilat përfshijnë jo vetëm ofrimin e shërbimeve postare dhe pagesave të ndryshme, por edhe ndihmën në forcimin e marrëdhënieve me konsumatorët dhe zhvillimin e një imazhi të fortë të brendit të Postës së Kosovës.

Një element tjetër i rëndësishëm i menaxhimit të DZHB-së është mbikëqyrja, zgjerimi dhe administrimi i rrjetit të gjerë të zyrave postare, që përfshinë ofrimin e shërbimeve postare, shpërndarjen e dërgesave dhe menaxhimin e marrëveshjeve me konsumatorët. Në periudhën janar-dhjetor 2024, janë ndërmarrë aktivitete të shumta që synojnë rritjen e të hyrave financiare dhe përmirësimin e performancës së përgjithshme të Postës së Kosovës.

Fokus dhe Aktivitetet Kryesore për vitin 2024:

1. Zgjerimi dhe Funkionimi i Rrjetit të Zyrave Postare:

- Një nga prioritetet kryesore të DZHB-së ka qenë zgjerimi i rrjetit të zyrave postare në gjithë territorin e Kosovës, duke siguruar që çdo qytetar të ketë qasje në shërbimet postare. Kjo përfshin instalimin dhe funksionimin e zyrave postare të reja, si dhe përmirësimin e kapaciteteve operacionale të atyre ekzistuese.

2. Përmirësimi i Shërbimeve Postare dhe Shpërndarjes së Dërgesave:

- Puna e vazhdueshme për ngritjen e cilësisë së shpërndarjes së dërgesave postare ka qenë një aspekt kyç i strategjisë së DZHB-së. Kjo është realizuar përmes optimizimit të proceseve logjistike dhe mbikëqyrjes së cilësisë së shërbimeve.

3. Raportimi dhe Monitorimi i Performancës:

- Një fokus i madh ka qenë implementimi i sistemeve të raportimit sipas kërkesave dhe afateve të përcaktuara, për të siguruar një transparencë të plotë dhe mbikëqyrje efektive të performancës. Ky aspekt ka përfshirë krijimin e raporteve të detajuara për performancën e shërbimeve dhe aktiviteteve të realizuara, si dhe monitorimin e shpenzimeve operative, përfshirë ato të derivateve.

4. Menaxhimi i Kontratave dhe Marrëveshjeve të Reja:

- Aktivitetet kanë përfshirë nënshkrimin e kontratave të reja dhe menaxhimin e marrëveshjeve të ekzistues. Një pjesë e rëndësishme e punës është menaxhimi i marrëveshjeve me operatorët ekonomikë dhe institucionet, si dhe promovimi i shërbimeve dhe produkteve të Postës së Kosovës.

Zhvillimet Operative

Gjatë vitit 2024, statusi i zyrove postare është përmbyllur me gjithsej 203 zyra postare, prej të cilave 152 ZP janë aktive, ndërsa 51 ZP kanë qenë jashtë funksionit dhe të uzurpuara.

Gjithashtu, periudha e këtij viti është përmbyllur me 274 sportele të automatizuara, me 214 kuti postare (publike) për pranim të dërgesave dhe me 3,171 kuti/faha postarë (Post Box) për dorëzim të dërgesave.

Në vijim, në formë tabelore janë të paraqitura të dhënat lidhur me statusin e zyrove postare.

Tabela 9: Statusi i zyrove postare në periudhën përmbyllëse të vitit 2024

Statusi i zyrove postare përmbyllëse 2024			
Zyra postare aktive	152	Numri i sporteleve të automatizuara	274
Zyra jo aktive (të uzurpuara ose jo funksionale)	51	Kuti postare (publike) për pranim të dërgesave	214
Zyra postare/ total	203	Kuti/faha postarë (Post Box) për dorëzim të dërgesave	3,171

Gjatë periudhës janar - dhjetor 2024, në kuadër të DO-së janë zhvilluar aktivitete të ndryshme për hapjen e zyrove postare në institucione, me qëllim të zgjerimit të rrjetit postar në gjithë territorin e vendit dhe ofrimin e shërbimeve për qytetarët, si dhe ngritjen e performancës financiare të ndërmarrjes.

Hapja e zyrove postare të reja në hapësirat e institucioneve, si dhe në hapësira private (me qira):

Gjatë periudhës së vitit 2024 janë zhvilluar aktivitete të ndryshme për hapjen e zyrove postare dhe si rezultat i këtyre aktiviteteve janë hapur këto ZP:

- ZP Graçanica 2 (K.K.);
- ZP Prishtina 18 (ARBK);
- ZP Banjska (Sta Policor);
- ZP Suhareka 3 (K.K.);
- ZP Krushë e Madhe- qender;
- ZP Prishtina 5 (Prishtine- qender);
- ZP Prishtina 27 (KK – objekti i vjetër);
- ZP Vushtrri 2 (K.K.);
- ZP Gjakova 5 (Gj.Th. Gjakovë);
- ZP Gjilani 3 (Gj. Th. Gjilan);
- ZP Mitrovica 5 (MPB-veri);
- ZP Prizreni 7 (Gj.Th. Prizren);
- ZP Fushë Kosova 3 (në objektin e Valës);
- ZP Drenas 3 (Gj. Th. -dega Drenas);
- ZP Soqanicë (K.K. Leposavic);
- ZP Prishtina 14 (ZP lagja Pejton);
- ZP Mitrovica Veriore 2 (ZP qender).

Gjithashtu, është bërë mbyllja/zhvendosja e disa zyrove postare:

- ZP Jarinje (mbyllur);
- ZP Prishtina 27 (ri-hapur);
- ZP Gjakova 06 (mbyllur);
- ZP Mitrovicë 4 - KK-Veri (mbyllur).

Hapja e zyrove postare në pjesën e Mitrovicës së Veriut:

Gjithashtu, gjatë vitit 2024 janë zhvilluar aktivitete me qëllim të shtrirjes së rrjetit të ZP-ve edhe në pjesën e Mitrovicës së Veriut, gjithnjë me qëllim të ofrimit të shërbimeve për qytetarët që jetojnë në këtë pjesë të territorit të Kosovës.

Si rezultat i këtyre aktiviteteve është bërë hapja e këtyre ZP-ve:

- ZP Mitrovica 5 (MPB-veri);
- ZP Banjska (Stacioni Policor).

Gjithashtu, është bërë mbyllja/zhvendosja e disa ZP-ve, të cilat janë bërë në koordinim me institucione, si: ZP Jarinje (mbyllur); ZP Gjakova 06 (mbyllur); ZP Mitrovicë 4 - KK-Veri (mbyllur) dhe ZP Prishtina 27, e cila është rihapur.


Të hyrat nga shërbimet dhe produkte në kuadër të PK-së:

Tabela 10: Të hyrat nga shërbimet postare vendore/ konsumatorët e mëdhenj

Shërbimet postare- Posta Vendore - konsumatorët e mëdhenj	Të Planifikuar	Arritëshmëria	%
	Janar-Dhjetor 2024		
	2,150,000 €	2,308,821 €	107%

Shënim: Të dhënat në tabelën më lart pasqyrojnë të hyrat nga shërbimet postare vendore, (institucionet/ndërmarrjet publike/private, kompanitë e ndryshme, avokatët, përmbaruesit etj.) të cilat sipas Biznes Planit 2024 janë realizuar për 107%, e që paraqet një ngritje për 7% në raport me planifikimin.

Figura 5: Shërbimet Postare




Shënim: Të dhënat në grafikonin më lart paraqesin krahasimin e të hyrave nga shërbimet postare vendore të realizuara në vitin 2023, gjatë vitit 2024 paraqitet një rritje e të hyrave. Gjegjësisht, në vitin 2023 janë realizuar të hyra prej 2,038.767, ndërsa në viti 2024 janë realizuar të hyra prej 2,308.821€ apo shprehur në përqindje të hyrat në vitin 2024 janë më të larta për 13% në raport me realizimin e të hyrave në vitin 2023.

Tabela 11: Të hyrat nga shërbimet Vala/Telekom

Vala /Telekom	Të Planifikuar	Arritëshmëria	%
	Janar - Dhjetor 2024		
	992,047 €	934,669 €	94%

Figura 6: Krahasueshmëria e realizimit 2024-2023




Shënim: Të dhënat në tabelën dhe grafikonin më lart pasqyrojnë të hyrat financiare lidhur me shitjen e produkteve dhe shërbimeve nga Telekom i Kosovës, të cilat krahas targetit në vitin 2024 është realizuar/arritur për 94%. Gjate kësaj periudhe nuk është rezultati sipas planifikimit marrë parasysh se Telekom i ka zgjeruar operimin me Pikat Shitëse në nivel Kosovës. Ndërsa krahasimi i të hyrave financiare 2023-2024 mbi shitjen e produkteve dhe shërbimeve nga Telekom i Kosovës, viti 2024 në raport me vitin 2023 kanë reflektuar me një ngritje për 7%. Rezultati i rritjes së të hyrave në 2024 në raport me vitin 2023 ka ndikuar nga lansimi i produkteve të TK-së në treg, përfshirë dhe oferta të pakove të internetit atraktive për konsumatorët. Gjithashtu ndikim ka pasur edhe hapja e zyrave postare të reja dhe zgjerim shërbimeve të reja që ka ndikuar pozitivisht në rezultatin e krahasuar për vitin aktual me atë paraprak .

Tabela 12: Të hyrat nga dërgesat online targetet/arritshmëria Janar - Dhjetor 2024

Shërbimet postare/ dërgesat online	Të Planifikuar	Arritëshmëria	%
	Janar-Dhjetor 2024		
	35,000 €	25,773 €	74%

Figura 7: Krahasimi i realizimit të të hyrat nga dërgesat online - 2024 me 2023



Shënim: Të dhënat në tabelën dhe grafikonin më lart pasqyrojnë të hyrat për dërgesat online të cilat, sipas Biznes Planit 2024 janë realizuar për 74%. Edhe përkundër se nuk është arritur targeti për shërbimet nga porosit online, disa kontrata të reja kanë ndikuar ndjeshëm në rritjen e shërbimit online gjatë vitit 2024, në krahasim me vitin 2023. Ndërsa krahasueshmëria e të hyrave për dërgesat online 2023-2024, përgjatë vitit 2023 rezultati ka qenë 8,738€ kurse në vitin 2024 në 25,773€ apo shprehur në përqindje 295% arritëshmëri.

Të hyrat nga shërbimet postare - Posta Ndërkombëtare:

Tabela 13: Të hyrat nga shërbimet postare - Posta Ndërkombëtare

SHËRBIMETPOSTARE-POSTA NËRKOMBETARE	Të Planifikuar	Arritëshmëria	%
	Janar-Dhjetor 2024		
	1,140,700 €	973,465 €	85%


Shënim: Të dhënat në tabelën më lartë pasqyrojnë të hyrat e realizuara nga shërbimet e postës ndërkombëtare të planifikuara në biznes plan 2024 në vlerë financiare 85%. Ndërsa krahasueshmëria e të hyrave për shërbimet e tjera postare ndërkombëtare 2023-2024, të cilat përgjatë vitit 2024 kanë pasur një ulje në raport me vitin 2023 për 3% si rezultat i konkurrencës dhe si pasojë e mos anëtarësimit në UPU.

Të hyrat nga shërbimet tjera postare:

Tabela 14: Të hyrat nga shërbimet tjera postare në vitin 2024

Shërbimet tjera postare dhe jo postare	Të Planifikuar	Arritëshmëria	%
	Janar-Dhjetor 2024		
	85,000 €	96,573 €	114%

Figura 8: Krahasimi i të hyrat nga shërbimet tjera postare 2024 më 2023



Shënim: Të dhënat në tabelën dhe grafikonin më lart pasqyrojnë të hyrat e realizuara nga shërbimet tjera postare dhe jo postare, të planifikuara në biznes plan 2024 në vlerë financiare 113%, tek kjo kategori e të të hyrave përfshihen të hyrat nga shërbimet e postës vendore, ems, vulave apostile, aplikimet për verifikimin e shtesave të fëmijëve. Ndërsa krahasueshmëria e të hyrave për shërbimet e tjera postare dhe jo postare 2023-2024, të cilat përgjatë vitit 2024 kanë pasur rritje në raport me vitin 2023 për 69% ky rezultat është arritur duke pas parasysh lansimin e shërbimeve të reja përgjatë vitit 2024 dhe avancimin e tyre në çdo zyrë postare në nivel të Kosovës.

Aktivitetet e Shitjes

Rritja e bashkëpunimit dhe aktivitetet me konsumatorë: Departamenti i Shitjes ka pasur një rol të veçantë në zgjerimin e bazës së konsumatorëve të Postës së Kosovës, me një fokus të veçantë në identifikimin e konsumatorëve potencial dhe menaxhimin e marrëdhënieve me konsumatorët ekzistues. Aktivitetet e këtij departamenti janë shtrirë në dy drejtime kryesore:

Bashkëpunimi me Konsumatorët e Mëdhenj

- Në periudhën janar-dhjetor 2024, Departamenti i Shitjes ka realizuar gjithsej 180 kontrata për shërbime me konsumatorë të mëdhenj, përfshirë 63 kontrata të reja dhe 117 kontrata të vazhduara. Ky proces ka përfshirë mbajtjen e takimeve të rregullta me konsumatorët dhe prezantimin e ofertave të shërbimeve postare, si dhe mirëmbajtjen e marrëdhënieve afatgjata.


Kontratat me Komunitet dhe Administrata Publike:

- Një kategori tjetër e rëndësishme është bashkëpunimi me komunitet për shpërndarjen e faturave të Tatimit në Pronë. Gjatë vitit 2024, janë realizuar gjithsej 33 kontrata me komunitet e vendit, me përjashtim të Komunitetit të Parteshit. Ky aspekt i bashkëpunimit është një element strategjik për sigurimin e një rrjeti të qëndrueshëm të shpërndarjes dhe rritjen e besueshmërisë së shërbimeve postare. Kontratat e Reja për Shërbime të Postës së Kosovës (2024) Në vitin 2024, janë nënshkruar gjithsej 63 kontrata të reja, të cilat janë të ndara sipas llojit të shërbimit.

Tabela 15: Kontratat e arritura gjatë vitit 2024 krahasuar me 2023

Janar - Dhjetor, 2024		
Kontrata të vazhduara	Kontrata të reja	Gjithsej
117	63	180
Janar - Dhjetor, 2023		
Kontrata të vazhduara	Kontrata të reja	Gjithsej
59	66	125

Figura 9: Krahasimi i kontratave 2024 – 2023



Aktivitetet e realizuara nga Filatelia gjatë vitit 2024

Filatelia e Postës së Kosovës, gjatë vitit 2024, përmes pamjeve të pullave postare ka shënuar data të rëndësishme të shtetësisë dhe historisë së Kosovës, duke nderuar, krijuar dhe prezantuar bukuri natyrore dhe thesaret e trashëgimisë kulturore.

Fondi i Filatelisë së Postës së Kosovës gjatë vitit 2024 u begatua me 18 emisione të reja të pullave postare, 14 nga të cilat me karakter të rregullt, ndërsa 4 me karakter të jashtëzakonshëm.

Në kuadër të programit të rregullt tematik të pullave postare janë emetuar emisione të ndryshme, si: "Qytetet-Istogu", "Flora endemike-lulet", "Fauna endemike-insektet", "Mbrojtja e ambientit", "Monumentet natyrore-trungjet", "Evropa 2024-flora dhe fauna nënujore", "Pyjet dhe rudinat", "Lojërat Olimpike Verore - Paris 2024", "Antropomorfet", "Kampionati Evropian i futbollit", "Pop roku i viteve '80", "Cjapi i bronztë", "Kalaja e Prizrenit" dhe "Objekte fetare".

Ndërkaq, përmes emisioneve të jashtëzakonshme, si: "15-vjetori i marrëdhënieve diplomatike Japoni-Kosovë" dhe "Ne jemi NATO, 25 vjet në Kosovë, së bashku më të fortë për paqen", janë nderuar miqtë e Kosovës, për përkrahjen e vazhdueshme nga ana e tyre dhënë Kosovës.

Gjithashtu, në bashkëpunim me Ministrinë e Drejtësisë, përmes pullës postare "Sot dhe çdo ditë tjetër", Posta e Kosovës ka qenë pjesë e fushatës senzibilizuese në parandalimin e dhunës gjinore. Ndërkaq në bashkëpunim me Ministrinë e Punëve të Jashtme, është realizuar emisioni i pullave postare në nderim të Heroit të Kosovës, Sali Çekaj.


Përmes emisioneve (18) të realizuara, në media, rrjete sociale, si dhe përmes marketingut janë publikuar të gjitha risitë nga Filatelia e Postës së Kosovës.

Përveç pullave të rregullta postare, janë realizuar 9 lloje të pullave të personalizuar, nga të cilat 8 lloje për persona fizik dhe 1 lloj për MPJD.

Në këtë periudhë janë prodhuar 280 pulla postare me nominale të ndryshme, gjë që ka bërë që të pasurohet fondi i Filatelisë së Postës së Kosovës.

Gjithashtu, përmes bashkëpunimit ndërinstitucional, është krijuar mundësia e vendosjes së ekspozitës së përhershme tematike në objektin e Qeverisë së Kosovës. Në këtë rast është bërë prezantimi i fondit të Filatelisë së Postës së Kosovës me emisionet e reja të pullave postare.

Në vijim janë paraqitur disa foto të përmbledhura të pullave postare të realizuara gjatë vitit 2024.



Kujdesi ndaj Konsumatorit

Gjatë periudhës janar- dhjetor 2024, Kujdesi ndaj Konsumatorit (KNK) është fokusuar në trajtimin e kërkesave, ankesave dhe pyetjeve të konsumatorëve të PK-së, gjithnjë me qëllim të orientimit dhe informimit të drejtë dhe të shpejtë rreth çështjeve që ndërlidhen me shërbimet postare që ofrohen në zyra postare të Postës së Kosovës. Gjatë periudhës janar-dhjetor 2024, KNK ka trajtuar gjithsej 15,014 kërkesa, ankesa, pyetje nga konsumatorë të ndryshëm dhe që të gjithë kanë marrë përgjigje përmes e-mailit, telefonit, viber-it, rrjeteve sociale, si: Facebook dhe Instagram, si dhe përmes takimeve direkte.


Marketingu

Gjatë vitit 2024, aktivitetet e Marketingut janë organizuar në pajtueshmëri me Planin e Biznesit, si dhe në përputhje me kërkesat e dala nga Shitja dhe Operativa. Gjithashtu, me qëllim të informimit sa më të drejtë të qytetarëve/konsumatorëve, janë realizuar shumë promovime të shërbimeve postare dhe fushata të ndryshme lidhur me promovimin e produkteve dhe shërbimeve të Postës së Kosovës, si fushatat me stafin dhe konsumatorët në rrjete sociale, për të cilat dizajnimi dhe publikimi është realizuar nga stafi i Marketingut.

Gjithashtu, janë organizuar aktivitete të ndryshme në kuadër të fushatave në bashkëpunim me institucionet shtetërore, është bërë lansimi i shërbimeve të reja, si dhe aktivitete tjera lidhur me shënimin e ditëve të veçanta dhe bashkëpunimin me ndërmarrjet tjera publike.

Në vijim, përmes paraqitjes grafike është pasqyruar arritshmëria në rrjete sociale gjatë vitit 2024, në krahasim me vitin 2023, që siç shihet gjatë vitit 2024 ka pasur një rritje të jashtëzakonshme krahasuar me vitet 2022 dhe 2023.


Figura 10. Paraqitja grafike - Krahasimi i arritshmërisë në rrjete sociale 2023 - 2024




Në ngritjen e numrit të vizitorëve ka ndikuar ndryshimi në qasjen dhe orientimin, në rëndësinë e rrjeteve sociale që kanë në ngritjen ‘brand awarness’ dhe me ndryshimin e përmbajtjes (content) si fushata me konsumatorë, aktivitetet, publikimet me staf, bashkëpunimi (collaboration) me kompani tjera.

Me kontratën për brendim po vazhdohet me ndryshimin e pamjeve të hyrjeve të zyrave postare, gjë që ka filluar me zyrat e reja dhe do të vazhdojë me zyrat kryesore.

Gjatë këtij viti është mundësuar brendimi i gjithsej 29 zyrave postare dhe njëkohësisht është bërë vendosja e 54 reklamave të reja ndriçuese. Kjo do të ndikojë direkt në ngritjen e imazhit të ndërmarrjes dhe në krijimin e hapësirave sa më joshëse për konsumatorët.



Aktivite të ndryshme



Drejtoria e Zhvillimit të Biznesit ka luajtur një rol të rëndësishëm në transformimin dhe modernizimin e shërbimeve dhe produkteve të Postës së Kosovës, duke i mundësuar asaj të rrisë efikasitetin operativ, të përmirësojë cilësinë e shërbimeve dhe të rrisë angazhimin me konsumatorët. Me strategjitë e saj të qarta dhe implementimin e aktiviteteve të menaxhuara me kujdes, DZHB ka kontribuar në forcimin e pozicionit të Postës së Kosovës si një lider në sektorin postar të vendit dhe stabilitet në shërbimet tjera jo postare.

Departamenti i Prokurimit

Gjatë vitit 2024, në Departamentin e Prokurimit janë dorëzuar/pranuar nga njësitë kërkuese gjithsej 44 kërkesa për inicim dhe zhvillim të procedurave të prokurimit.

Lidhur me kërkesat e dorëzuara/pranuara nga njësitë kërkuese gjatë vitit 2024, Departamenti i Prokurimit ka bërë përgatitjet, njoftimet dhe publikimet e tyre përmes sistemit të E-Prokurimit, po ashtu ka pranuar kërkesa dhe janë mbajtur korrespondenca me OE-të përmes e-mailave dhe letrave standarde.

Gjatë këtij viti, sipas kërkesave të pranuar, Departamenti i Prokurimit ka zhvilluar procedurat e prokurimit dhe ka nënshkruar 44 kontrata me operatorë të ndryshëm ekonomik. Ndërsa 7 aktivitetet, të cilat kanë filluar gjatë vitit 2024, kanë mbetur të implementohen në vitin 2025 (për shkak të afateve ligjore).

Gjatë këtij viti, në Drejtorinë e Prokurimit, si sfidë dhe pengesë ka qenë mungesa e ofertimit nga operatorët ekonomik në disa aktivitete, si dhe ndërprerja e disa kontratave për shkak të dështimit të operatorëve ekonomik që t'i implementojnë të njëjtat.

Inspektorati

Pasqyra vjetore e inspektimeve

Inspektorati Postar, gjatë vitit 2024 ka kryer inspektime dhe aktivitete inspektuese, sipas planit të punës për periudhën janar - dhjetor 2024. Gjithashtu, sipas autorizimit të KE-së, janë kryer inspektime të jashtëzakonshme (emergjente) dhe është bërë trajtimi i ankesave të konsumatorëve, si dhe janë zhvilluar aktivitete tjera inspektuese lidhur me mbarëvajtjen e proceseve të punës në zyra postare.

Gjatë vitit 2024 janë realizuar 153 inspektime në zyra postare, 379 aktivitete inspektuese përmes sistemit të SASP-it, si dhe 110 aktivitete tjera inspektuese. Gjithashtu janë vizituar rreth 805 lokacione për verifikim të shpërndarjes së faturave të tatimit në pronë dhe pasqyrave të Trustit Pensional.

Nga gjithsej 153 aktivitete/inspektime të realizuara, 70 prej tyre janë realizuar në fushën e shërbimeve postare, 51 janë inspektime financiare dhe 32 janë aktivitete për monitorimin e shpërndarjes së faturave të tatimit në pronë, të realizuara në më shumë se 805 lokacione të ndryshme.

Përveç këtyre, gjatë kësaj periudhe janë realizuar edhe 110 aktivitete të tjera inspektuese në zyra postare, me fokus identifikimin e njohurive për kryerjen e shërbimeve postare.

Gjithashtu, nga gjithsej 153 inspektime të realizuara në ZP, prej tyre 109 inspektime janë të planifikuara (të rregullta), ndërsa 44 inspektime emergjente (të paplanifikuara).

Në tabelën më poshtë janë të paraqitura aktivitetet inspektuese të realizuara përmes SASP-it dhe pjesa tjetër e aktiviteteve inspektuese në zyra postare dhe lokacione tjera, të planifikuara dhe realizuara gjatë vitit 2024.

Tabela 16. Inspektimet e planifikuara dhe të realizuara gjatë vitit 2024

Fushat e inspektimeve	Të planifikuara	Të realizuara	Përqindja %
Shërbimet postare	72	70	97%
Monitorimi i faturave të tatimit në pronë dhe Trustit Pensional	61	32	52%
Shërbimet Financiare	72	51	70%
Aktivitete tjera inspektuese në zyra postare	80	110	138%
Aktivitete inspektuese përmes SASP-it	300	379	126%
Totali	585	642	109%

Efektet e inspektimeve dhe aktiviteteve përgjatë vitit 2024

Përmes aktiviteteve inspektuese është arritur të bëhet identifikimi i parregullsive dhe shkeljeve të rregullave të punës, gjë që ka ndikuar në ngritjen e disiplinës dhe përgjegjësisë në punë për stafin e zyrave postare. Gjithashtu, përmes inspektimeve dhe aktiviteteve të ndërmarra gjatë kësaj periudhe është arritur ngritja e përgjegjësisë dhe

llogaridhënies në nivel më të lartë (regjional) të ndërmarrjes, lidhur me kontrollin dhe monitorimin e procesit të punës.

Në vijim janë disa nga pikat e trajtuara, të cilat konsiderohen se kanë pasur efekt pozitiv në procesin e punës gjatë periudhës janar-dhjetor 2024:

- Rekomandimi lidhur me përditësimin e vendbanimeve në SASP;
- Ngritja e cilësisë lidhur me rapo-timin e rekapitullimeve për konsumatorët e mëdhenj (nga zyrtarët e regjioneve);
- Ngritja e cilësisë së shpërndarjes së dërgesave postare, e cila është arritur si rrjedhojë e inspektimeve dhe masave ndëshkuese ndaj punonjësve në sektorin e shpërndarjes;
- Identifikimi i mangësive, parregullsive dhe shkeljeve në proceset e punës;
- Vlerësimi i efikasitetit në proceset e punës;
- Parandalimi i shkeljeve të akteve të brendshme të ndërmarrjes;
- Zbatimi i standardeve, rregullave dhe procedurave në fuqi;
- Përdorimi i efektshëm i resurseve rjerëzore të ndërmarrjes;
- Përmirësimi i imazhit të ndërmarrjes, etj.

Kontrolli i Brendshëm

Aktivitetet e DKB-së të realizuara përgjatë vitit 2024

Sipas detyrave dhe përgjegjësiave, Departamenti i Kontrollit të Brendshëm (DKB), gjatë vitit 2024 ka zhvilluar aktivitete ditore lidhur me verifikimin elektronik të listave të nënshkrimeve, si dhe për verifikimin/mbikëqyrjen e prezencës së punonjësve të ndërmarrjes në vendet e tyre të punës për drejtoritë, departamentet dhe stafin administrativ të regjioneve të PK-së.

Vlen të ceket së në fund të vitit 2024, ka filluar implementimi i sistemit të ri të kontrollit të hyrje-daljeve të punonjësve, të cilët punojnë në disa prej objekteve të PK-së, siç janë: objekti qendror i PK-së, objekti i QTP-së në Fushë Kosovë dhe të gjitha objektet kryesore në shtatë (7) regjionet e PK-së.

Tabela 17: Verifikimi elektronik i listave të nënshkrimeve dhe prezencës së punonjësve në punë gjatë vitit 2024

Viti 2024	Ditë pune gjatë 2024	Nr. i listave të nënshkrimeve të drejtorive, departamenteve dhe stafit administrativ të regjioneve	Nr. i punonjësve për të cilët bëhet verifikimi elektronik (ditor)	Nr. i verifikimeve elektronike i listave të nënshkrimeve gjatë vitit 2024
TM 1	61	26	310	1586
TM 2	60	26	310	1560
TM 3	66	78	849	1716
TM 4	44	52	566	1144
Gjithsej	225	182	2035	6006

Gjithashtu, në fillim të vitit 2024, DKB-ja ka vazhduar të angazhohet në procesin për monitorimin e regjistrimit të mjeteve themelore të PK-së për vitin paraprak 2023, proces ky i cili ka përfunduar më datë 03.04.2024.

Gjatë kësaj periudhe DKB është angazhuar edhe në aktivitetin e komisionit për "Monitorim, mirëmbajtje dhe servisim të sistemit të alarmeve, furnizimit me pjesë rezervë dhe shërbime me roje fizike për nevoja të PK-së".

Gjithashtu, sipas kërkesës së Menaxhmentit, DKB në disa raste është angazhuar edhe në procesin e mbikëqyrjes së pushimeve mjekësore, gjegjësisht në kontrollin dhe verifikimin e pushimeve mjekësore, të shfrytëzuara nga punonjës të caktuar të PK-së.

Përveç këtyre aktiviteteve, DKB është angazhuar edhe në procesin e monitorimit/kontrollit të kontratës me titull: “Monitorimi, mirëmbajtja dhe servisi i sistemit të alarmeve, furnizimi me pjesë rezervë dhe shërbime me roje fizike për nevoja të PK-së”.

Aktivite monitoruese dhe kontrolluese të DKB-së janë zhvilluar edhe në lidhje me dyshimet për keqpërdorim të procesit të punës lidhur me dyshimet për keqpërdorim të derivateve nga ana e punonjësve të PK-së, si dhe lidhur me respektimin e Urdhëresës për ndalimin e duhanit në ambientet e brendshme të PK-së.

Gjithashtu, sipas vendimit të datës 21.11.2024, nr. 01-2713/24, punonjësit e DKB-së janë caktuar në Komisionin Monitorues për Regjistrimin e Mjeteve Themelore të PK-së dhe gjatë muajit dhjetor kanë monitoruar procesin e regjistrimit të mjeteve themelore nëpër regjione të PK-së.

Drejtoria e Financave – DF

Departamenti i Institucionit Financiar Jo Bankar - DIFJB

Viti 2024 është karakterizuar me mbajtjen e vazhdueshme të raportimeve zyrtare obligative me institucionet relevante mbikëqyrëse të shtetit, me raportime të rregullta, barazime financiare, kujdes ndaj konsumatorëve, etj. Gjithashtu, janë realizuar edhe aktivitete të shumta biznesore lidhur me implementimin e kontratave të reja, zgjerimin e rrjetit të ZP-ve për pagesa, si dhe aktivitete tjera lidhur me arritjen e objektivave të IFJB-së, të cilat kanë rezultuar në realizimin dhe tejkalimin e Planit të Biznesit.

Aktivitetet e IFJB-së gjatë vitit 2024 dhe numri i pagesave

Në vazhdim, në formë tabelore janë paraqitur të hyrat nga IFJB, numri i pagesave/transaksioneve të realizuara gjatë vitit 2024, si dhe krahasimi me vitin 2023.

Tabela 18 : Numri i pagesave / transaksioneve të realizuara gjatë viteve 2023 dhe 2024

Numri i pagesave	2023	2024	Diferenca	Rritjet/rënie %
Totali	2,528,959	2,697,161	168,202	7%

Në vitin 2023 janë realizuar gjithsej 2,528,959 pagesa/transaksione, ndërsa në vitin 2024 janë realizuar gjithsej 2,697,202 pagesa/transaksione, që do të thotë se në këtë vit (2024) është paraqitur një rritje e numrit të pagesave për 168,202, apo për 7% më shumë krahasuar me vitin 2023.

Në tabelën më lart është paraqitur numri i transaksioneve/pagesave të realizuara sipas regjioneve të PK-së. Siç mund të shihet, gjatë vitit 2024 në të gjitha regjionet e PK-së është shënuar rritje e numrit të pagesave/transaksioneve krahasuar me vitin paraprak (2023).

Numri më i lartë i transaksioneve të realizuara në vitin 2024, nga regjioni i Prishtinës, Prizrenit dhe Mitrovicës, ka ardhur si rezultat i zgjerimit të rrjetit të zyrave postare për ofrimin e shërbimit të pagesave në këto regjione, e posaçërisht në veri të vendit.

Shpërndarja e Asistencave Sociale gjatë vitit 2024

Tabela 19: Shpërndarja e Asistencave Sociale gjatë vitit 2024

Posta Kosovës	Numri i Asistencave të tërhequra	Shuma e paguar	Provizioni për Postën
Viti 2024	236	20,380 €	472 €

Është bërë barazimi mes Postës së Kosovës dhe MFPT për shpërndarjen e Asistencës Sociale për kategoritë: Azilantë dhe Refugjatë. Gjithashtu, lista dhe fondet e pa tërhequra janë trajtuar duke i kthyer prapa në Ministri (MFPT), përmes Financave Qendrore të PK-së, ndërsa shuma e provizionit i është faturuar Ministrisë.

Raporti financiar /2024:

Tabela 20: Qarkullimi i përgjithshëm dhe të hyrat gjatë viteve 2023-2024

Përshkrimi	Viti 2023	Viti 2024	Diferenca €	Diferenca %
Qarkullimi i përgjithshëm	125,422,332 €	159,823,385 €	34,401,052 €	27%
Të Hyrat / Provizioni	1,852,485€	1,951,063 €	98,578€	5%

Tabela 21: Planifikimi dhe realizimi gjatë vitit 2024

Posta e Kosovës	Planifikimi me PB	Realizimi i PB	Diferenca nga PB (në vlerë monetare)	Diferenca nga PB (në %)
2024	1,900,000 €	1,951,063 €	51,063 €	3%

Bazuar në projeksionin buxhetor për vitin 2024 janë planifikuar të hyra 1,900,000 €, kurse janë realizuar 1,951,063€, që paraqet tejkalim të planifikimit për 51,063€ apo për 3% më shumë.

Në tejkalimin e projeksionit buxhetor dhe rritjen e numrit të pagesave në vitin 2024m, krahasuar me vitin 2023, kanë ndikuar disa faktorë, si: zgjerimi i rrjetit të zyrave postare për ofrimin e shërbimit të pagesave, realizimi i kontratave të reja, marketingu, trajtimi dhe evitimi i gabimeve, të cilat kanë ndodhur gjatë ekzekutimit të pagesave, gjë që ka ndikuar në ruajtjen dhe forcimin e besimit ndaj konsumatorëve ekzistues, si dhe në rritjen e numrit të konsumatorëve të rinj, etj.

Performanca operative dhe indikatorët kyç të performancës

Viti 2024 ka qenë një vit i rëndësishëm dhe i suksesshëm për Postën e Kosovës (PK), duke shënuar një moment historik në rrugëtimin e saj si një ndërmarrje e pavarur. Ky është viti i parë që nga ndarja nga PTK, ku Posta ka arritur të realizojë një rezultat afarist pozitiv, duke reflektuar përmirësim të ndjeshëm në menaxhimin financiar, optimizimin e burimeve dhe zhvillimin e shërbimeve të reja.

Në një mjedis tregtar të sfiduar nga transformimet digjitale dhe konkurrenca në rritje, Posta e Kosovës ka demonstruar aftësi të forta për adaptim dhe inovacion. Përmes një strategjie të përcaktuar mirë, ndërmarrja ka arritur të ruajë stabilitetin financiar, të zgjerojë shërbimet dhe të diversifikojë burimet e të hyrave, duke krijuar kështu një bazë të fortë për rritje të mëtejshme në vitet në vijim.

Gjatë vitit 2024, të hyrat e realizuara kanë arritur vlerën prej 10,416,745 euro, duke shënuar një rritje prej 4% krahasuar me realizimin e vitit 2023. Megjithëse rezultati ka qenë 1% më i ulët se pritshmëria e planifikuar për vitin 2024, kjo diferencë është e vogël dhe nuk ka ndikuar negativisht në performancën e përgjithshme afariste.

Këto rezultate tregojnë për një rrugë të qëndrueshme zhvillimi, duke dëshmuar se Posta e Kosovës jo vetëm që ka siguruar një stabilitet financiar, por gjithashtu po zgjeron ndikimin e saj në sektorë të ndryshëm të tregut. Me një fokus të vazhdueshëm në modernizim dhe përmirësim të shërbimeve, Posta është në rrugën e duhur për të forcuar pozitën e saj si një aktor kyç në industrinë postare dhe të logjistikës në Kosovë.

Performanca financiare dhe rezultatet

Posta e Kosovës Sh.A., në përputhje me Planin e Biznesit të aprovuar nga Bordi i Drejtorëve, për vitin fiskal 2024 ka planifikuar një total prej 10,503,060€ të hyra nga veprimtaria e saj, si dhe 1,327,252€ të hyra nga kompensimi për Shërbimin Universal Postar (SHUP).

Gjatë kësaj periudhe, Posta e Kosovës ka arritur të realizojë 10,416,745€ të hyra, duke shënuar një diferencë negative prej 86,315€ ose -1% më pak se sa ishte planifikuar. Megjithatë, krahasuar me vitin e kaluar (2023), të hyrat kanë shënuar një rritje prej 4%, duke reflektuar një trend pozitiv në përmirësimin e performancës afariste. Pavarësisht këtyre sfidave, Posta e Kosovës vazhdon të presë kompensimin e planifikuar për Shërbimin Universal Postar (SHUP), bazuar në precedentët e viteve të mëparshme. Për vitin 2024, vlera e llogaritur bazuar indikatorëve për këtë kompensim është rreth 1.2 milion euro, duke qenë një komponent i rëndësishëm në bilancin financiar të ndërmarrjes.


Përkundër sfidave në realizimin e të hyrave të planifikuara, Posta e Kosovës ka siguruar stabilitetin financiar. Përkundër këtyre vështirësive në realizimin e të hyrave, Posta e Kosovës ka arritur që t’iu shërbejë konsumatorëve të vet në çdo çast, si rezultat i menaxhimit efikas të shpenzimeve operative dhe inkasimit të borxheve të vjetra.

Tabela 22: Pasqyra e të ardhurave

Përshkrimi	Realizimi 2024	Realizimi 2023	Dif.	Dif. %
Të hyrat nga shitja	10,416,745	10,063,329	353,416	104%
KMSH	468,057	342,129	125,928	137%
Fitimi Bruto	9,948,688	9,721,200	227,488	102%
Shpenzimet operative	1,521,324	1,607,335	-86,011	95%
Shpenzimet e personelit	7,946,108	8,129,539	-183,431	98%
Zhvlerësimi dhe amortizimi	1,425,605	1,514,469	-88,865	94%
Total shpenzimet	9,467,432	9,736,873	-269,441	97%
Kompensimi ShUP	1,237,856	1,494,257	-256,401	83%
Fitimi/ Humbja e vitit	286,472	-44,211	330,683	-648%

Pasqyrat e vitit 2024

Figura 11: Paraqitja grafike e të hyrave




Në grafikun më lart janë paraqitur të hyrat nga aktivitetet e biznesit - shitja, si vijon:

- Të hyrat nga shërbimet postare 1,328,687 apo 12.76%
- Të hyrat nga shërbimet e konsumatorët e mëdhenj 2,308,821 apo 22.16%
- Të hyrat nga IFJB 1,951,137 apo 18.73%
- Të hyrat nga Telekomit 934,669apo 8.97%
- Të hyrat nga qiraja 3,772,580 apo 36.22%
- Të hyrat tjera 120,851 apo 1.16%

Gjithsej përqindja e arritur e të hyrave në 2024 është 100%.


Figura 12: Paraqitja grafike sipas llojit të të hyrave



Gjatë vitit 2024, ndërmarrja i ka kushtuar rëndësi të veçantë edhe uljes së shpenzimeve operative. Krahasuar me vitin 2023, shpenzimet operative (përfshirë edhe shpenzimet e personelit) janë më të ulëta për 3% apo për 269,441€, ndërsa krahasuar me PB, këto shpenzime janë më të ulëta për 9% apo për 972,199 €. Kostoja më e lartë e ndërmarrjes vazhdon të jetë kostoja e stafit që paraqet 70% të kostonë së përgjithshme të shpenzimeve.

Në vazhdim, me anë të grafikut janë pasqyruar shpenzimet e lartcekura.

Figura 13. Paraqitja grafike e shpenzimeve



Indikatorët kyç financiar

Tabela 23: Indikatorët financiar

Përshkrimi	Realizimi 2024	Realizimi 2023	Koment
Fitimi Operativ Margjinal = Fitimi Neto/gjithsej të hyrat	14.7%	12.7%	Kompania është duke operuar me fitim
Treguesi i Qarkullimit = Asete qarkulluese/Detyrimet qarkulluese	2.2%	2.6%	Ka ramje nga periudha 2023
Mbulimi i shpenz. operative = gjithë të hyrat/shpenz. operative	123%	119%	Treguesi duhet të jetë më i madh se 1.
Mbulimi i Të hyrave = Gjithë të hyrat / Shpenzimet e lejuara	1.42	1.38	Treguesi duhet të jetë më i madh se 1.
Mbulimi i shpenz. te lejuara = shpenz. e lejuara /gjithë të hyrat	2.3%	2.1%	Treguesi duhet të jetë më i vogël se 1 apo 1
% Shpenzimeve të punonjësve ndaj total të hyrave	68%	70%	Idealja 30%



posta  POSTA E SHQIPËRISË
POSTAL SERVICE

shpejt, sigurt dhe lirë!

Progresi me Planin e Biznesit

Gjatë vitit 2024, nga të dhënat e paraqitura rezultojnë një realizim i planit të të hyrave për 99%. Planifikimi i të hyrave si tërësi për periudhën janar - dhjetor 2024 ka qenë 10,503.060 euro (*me rishikim të buxhetit*), ndërsa realizimi 10,416,745 euro.

Rezultati përfundimtar financiar ka rezultuar me afarizëm pozitiv/fitim prej 286,472 euro që krahasuar me planifikim është një performancë shumë e mirë, duke pasur parasysh se vitin paraprak humbja ka qenë 44,211 euro. Pra, bilanci i suksesit është për 330,683 euro më i mirë se viti 2023. Ndërsa, krahasuar me PB, bilanci i suksesit është më i mirë për 744,132 euro.

Gjatë periudhës janar-dhjetor 2024, për të realizuar objektivin e parë financiar dhe operativ, që paraqet rritje të të hyrave nga shitja krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit paraprak, janë ndërmarrë aktivitete funksionale që të sigurohet një shërbim më cilësor, më i sigurt, më i lirë, më i shpejtë, si dhe transport (*shpërndarje*) pa problem dhe me kohë, me anë të kapaciteteve momentale që ekzistojnë.

Në kuadër të këtyre aktiviteteve, janë bërë dhe vazhdon të bëhet planifikimi, organizimi dhe ofrimi i këtyre shërbimeve në rrjetin e zgjeruar të zyrave postare të shitjes (17 ZP në vitin 2024) në gjithë territorin e Republikës së Kosovës. Në Planin e Biznesit, me rishikimin e buxhetit, janë ulur (*minimizuar*) shpenzimet operative në një sasi të konsiderueshme, duke iu dhënë prioritet projekteve kapitale, si: investimeve në teknologjinë informative, mjeteve të transportit, ofrimin e shërbimeve cilësore, të shpejta e të sigurta, realizimin e planit të biznesit me performancë pozitive. Bazuar në dinamikat e punëve, angazhimeve dhe aktiviteteve që janë duke u ndërmarrë dhe që do të ndërmerren në të ardhmen, si dhe me përkrahjen e aksionarëve, e ardhmja e kompanisë "Posta e Kosovës" është e sigurt, ndërsa tejkalimi i realizimit të planit të biznesit (*në të ardhmen*) është shumë premtues dhe i sigurt.

Shpenzimet kapitale dhe të projekteve

Në vitin 2024, prej projekteve kapitale të planifikuara në PB 2023-2025, janë realizuar 10 projekte kapitale në vlerën prej 342,903.69€, si më poshtë:

- Furnizim me 7 vetura të transportit të dërgesave postare në vlerë: 209,804€;
- Furnizim me produkte të licencuara të Microsoft në vlerë: 62,333.38€;
- Furnizim me reklama ndriçuese në vlerë: 21,434.13€;
- Evidentimi i vijueshmërisë së personelit në vlerë: 11,623€;
- Renovimi i zyrave postare në vlerë: 2,496.88€;
- Renovimi i nyjave sanitare nëpër objektet e PK-së në vlerë: 4,362€;
- Furnizim me barcode reader në vlerë: 4,787.42€;
- Renovimi i ZP- zgjerimi i sallës së postierëve ZP 6 - Adaptimi i zyrës postare 2 në vlerë: 2,737.60€;
- Renovimi dhe adaptimi i ZP Toskana në vlerë: 10,420.28€;
- Furnizim me pajisje të klimatizimit në vlerë: 12,905€.

Realizimi i Projekteve Kapitale 2024

Gjatë dy viteve të fundit, PK, me qëllim të rregullimit të infrastrukturës së transportit të dërgesave, zyrave postare, pajisjeve për punë, etj., ka bërë mjaft investime kapitale, të cilat kanë ndikuar drejtpërdrejt në efikasitet të përbushjes së obligimeve të punës dhe kërkesave të klientëve. Vlera e pagesave për investime kapitale ka qenë 971,793 euro për dy vitet e fundit (2023-2024).

Tabela 24. Statusi i projekteve të PK Sh.A.

Statusi i projekteve kapitale 2024	
Vlera e projekteve të aprovuara sipas Planit të Biznesit 2024 me mbështetje nga aksionari	3,738,122€
Vlera e projekteve të aprovuara sipas Planit të Biznesit 2024 me vetëfinancim	1,578,373€

Plani i investimeve (shpenzimet kapitale) është zhvilluar në përputhje me Metodologjinë për Planifikimin e Investimeve d.m.th. aty ku ekzistojnë zgjedhje alternative për tejkalimin e problemeve të identifikuara, për shkak të dështimit të procedurave të prokurimit, disa projekte detyrimisht do të barten në periudhat në vijim.

Për shkak të shpërndarjes së investimeve në vite, disa prej projekteve janë paraqitur si projekte planifikuese në Raportin Vjetor të vitit 2024, prandaj vlerat e tyre do të freskohen çdo vit në planin vijues të biznesit.

PK Sh.A. kryesisht ka fokusuar planin e investimeve të veta në mirëmbajtjen kapitale, që të mirëmbajë performancën e aseteve infrastrukturore dhe jo-infrastrukturore më shumë se sa në ngritjet kapitale, për të plotësuar rritjen e kërkesave për shërbime nga konsumatorët ekzistues, si dhe ata të rinj.

Gjatë vitit 2024 janë kontraktuar 10 projekte në vlerë totale prej 471,988.91 euro, ndërsa pjesa tjetër e projekteve, të cilat gjatë vitit 2024 kanë qenë në procedura të prokurimit, janë bartur në vitin 2025. Të gjitha këto janë planifikuar të financohen nga mjetet vetanake. Gjatë periudhës raportuese është bërë pagesa e OE-ve në vlerë prej 342,903.69€.

Vonesa në implementimin e projekteve ka rezultuar si pasojë e inkasimit me vonesë të kompensimit të SHUP. Inkasimi i tyre është realizuar në muajin dhjetor/2024.

Përveç planifikimit nga vetëfinancimi, për planifikim të projekteve kapitale është pritur mbështetje nga aksionari apo edhe nga donacionet. Mirëpo, gjatë këtij viti nuk ka pasur financime të këtij lloji.

Investimet Kapitale - Teknologjia Informative

PK Sh.A. për vitin 2024 ka realizuar projekte të teknologjisë informative, përfshirë edhe projektet në vazhdimësi, në total në vlerën 109,675.80 €, të cilat ndikojnë pozitivisht drejtpërsëdrejti në zhvillimin e PK Sh.A., si dhe janë proceduar kërkesat në ministrinë e linjës për financimin e këtyre projekteve, duke pasur parasysh gjendjen financiare të kompanisë.

Perspektiva Strategjike për Vitin 2025 – PK Sh.A.

Qëllimet dhe objektivat strategjike për vitin 2025:

- Diversifikimi dhe inovacioni në portofolin e produkteve dhe shërbimeve – Zhvillimi i shërbimeve të reja dhe inovative për të përmbushur kërkesat e ndryshueshme të konsumatorëve dhe për të qëndruar konkurrues në treg. Kjo përfshin ofrimin e mundësive të reja dhe të personalizuara që mund të krijojnë vlerë të shtuar për klientët.
- Përmirësimi i cilësisë dhe përputhshmërisë – Vazhdimi i angazhimit për t'u përputhur me standardet ndërkombëtare dhe për të përmirësuar proceset dhe produktet për të siguruar cilësi të lartë dhe besueshmëri të vazhdueshme për konsumatorët.

- Rritja e të hyrave dhe zgjerimi në mundësi të reja biznesi – Krijimi i mundësive të reja për të rritur të ardhurat, duke përfshirë zhvillimin e shërbimeve të reja, eksplorimin e tregjeve të reja dhe krijimin e partneriteteve strategjike.
- Forcimi i marrëdhënieve me konsumatorët – Rritja e angazhimit dhe besnikërisë së konsumatorëve përmes përmirësimit të shërbimit ndaj tyre dhe ofrimit të mundësive për komunikim dhe feedback, duke u siguruar që nevojat dhe kërkesat e tyre plotësohen gjithmonë në mënyrë efikase.
- Zbatimi i politikave tarifore të qëndrueshme dhe të përballueshme – Zhvillimi i politikave tarifore që mbulojnë kostot operacionale dhe mbështesin investimet strategjike, duke siguruar që tarifatat të mbeten të përballueshme për konsumatorët dhe të ofrojnë një balancë mes qëndrueshmërisë financiare dhe aksesit në shërbime.
- Zgjerimi i pranisë në tregun e Kosovës – Rritja e ofrimit të shërbimeve dhe produkteve në të gjithë Kosovën për të pasur një ndikim më të madh dhe për të arritur konsumatorë të rinj.
- Zhvillimi i Teknologjisë së Informacionit dhe digjitalizimi – Zbatimi i teknologjive më të avancuara për të përmirësuar efikasitetin e shërbimeve, duke përfshirë integrimin e platformave digjitale që mundësojnë akses të shpejtë dhe të sigurt në shërbime, dhe përdorimin e analizave të të dhënave për të përmirësuar vendimmarrjen.
- Rritja e volumit të transaksioneve dhe pagesave nga SHFJB – Automatizimi i sistemeve të pagesave për të rritur efikasitetin dhe për të garantuar një shërbim më të shpejtë dhe më të sigurt për konsumatorët.
- Krijimi i një ambienti pune motivues dhe ristrukturimi i stafit – Zhvillimi i një strukture organizative fleksibile dhe moderne që mbështet inovacionin dhe rrit produktivitetin. Ristrukturimi i stafit dhe krijimi i mundësive për zhvillim profesional dhe rritje të aftësive për të përballuar kërkesat e tregut.
- Mirëmbajtja dhe zhvillimi i infrastrukturës teknologjike – Investimi në infrastruktura që mbështesin qëndrueshmërinë dhe rritjen e performancës, duke përfshirë modernizimin e sistemeve për t'u përshtatur me kërkesat e tregut dhe teknologjinë e avancuar.
- Përfundimi i projekteve kapitale – Realizimi i projekteve të rëndësishme investuese dhe zhvillimore që mundësojnë rritjen e kapaciteteve operative dhe përmirësimin e efikasitetit në ofrimin e shërbimeve.
- Sigurimi i faturimit të saktë dhe në kohë – Zhvillimi i sistemeve të automatizuara të faturimit për të garantuar saktësi dhe përputhshmëri me kërkesat rregullatore, duke minimizuar mundësinë e gabimeve dhe vonesave.
- Përditësimi i Sistemit të Informacionit – Rritja e saktësisë dhe funksionalitetit të sistemeve të informacionit për të siguruar të dhëna të besueshme dhe të përditësuara që mbështesin vendimmarrjen strategjike dhe operacionale.
- Zgjerimi i bazës së konsumatorëve dhe inkasimi i borxheve – Krijimi i mundësive të reja për të angazhuar konsumatorët dhe përmirësimi i proceseve të inkasimit për të siguruar që të gjitha detyrimet të paguhen në kohë dhe pa pengesa.
- Zgjerimi i kontratave ekzistuese dhe identifikimi i mundësive të reja – Negocimi i kontratave të reja dhe krijimi i mundësive për rritjen e pjesës së tregut dhe të ardhurave, duke përfshirë mundësitë për partneritete të reja dhe bashkëpunime strategjike.
- Informimi dhe ndërgjegjësimi i konsumatorëve për shërbimet – Zhvillimi i fushatave të komunikimit dhe marketingut për të informuar konsumatorët për shërbimet dhe përfitimet e ofruara, duke rritur përdorimin e shërbimeve dhe përmirësuar ndërveprimin.

- Trajnimi dhe zhvillimi i stafit – Investimi në trajnime për të përmirësuar aftësitë profesionale të stafit dhe për t'i përgatitur ata për të përdorur teknologjitë dhe metodat më të reja për rritjen e efikasitetit.
- Optimizimi i Sistemit të Menaxhimit të Informacionit (SMI) – Përmirësimi i Sistemit të Menaxhimit të Informacionit për të siguruar që të dhënat të jenë të integruara dhe të përdorura për të përmirësuar proceset operative dhe strategjike.

Objektivat strategjike të kompanisë për periudhën e ardhshme

Përmirësimi i Cilësisë dhe Infrastrukturës së Shërbimeve

- Rritja e sigurisë, shpejtësisë dhe cilësisë në ofrimin e shërbimeve postare.
- Modernizimi dhe renovimi i infrastrukturës së zyrave postare për të përmirësuar përvojën e klientit.
- Rritja e efektivitetit në ofrimin e shërbimeve postare përmes optimizimit të proceseve dhe burimeve.
- Përmirësimi i kushteve të punës dhe plotësimi i nevojave operacionale për të mbështetur efikasitetin e brendshëm.

Zhvillimi dhe Zgjerimi i Aktivitetit të Shitjes

- Zhvillimi dhe zbatimi i strategjive të përmirësuara të shitjes për të rritur të ardhurat dhe penetrimin në treg.
- Diversifikimi i portofolit të produkteve dhe shërbimeve, duke përfshirë iniciativa të reja si Post Banka dhe Qendra Logjistike.
- Zgjerimi i gamës së shërbimeve për të adresuar nevojat e tregut dhe për të përmirësuar konkurrueshmërinë.
- Rritja e numrit të pagesave nga SHFJB përmes optimizimit të proceseve dhe ofrimit të shërbimeve të integruara.

Strategjia e Marketingut dhe Qasja ndaj Konsumatorëve

- Marketing i kombinuar:
- Marketing direkt përmes stafit në terren dhe zyrave postare.
- Marketing digjital përmes platformave online dhe rrjeteve sociale për të zgjeruar praninë në treg.
- Promovimi i produkteve dhe shërbimeve të reja dhe ekzistuese përmes kanaleve tradicionale dhe digjitale.
- Qasje e diferencuar ndaj konsumatorëve:
- Fokus tek konsumatorët e rregullt për të rritur besnikërinë.
- Penetrim në treg për të tërhequr konsumatorë të rinj dhe potencialë.
- Hulumtim i vazhdueshëm i tregut për të adresuar në mënyrë proaktive kërkesat e konsumatorëve.
- Zbatimi i metodave të ndryshme të promovimit dhe shitjes, përfshirë prezantimin elektronik, derë më derë dhe përmes qasjes telefonike.

4. Rritja e Efikasitetit Operacional dhe Cilësisë

- Zbatimi i mekanizmave për kontrollin dhe sigurimin e cilësisë në përputhje me rregulloret dhe standardet e industrisë.
- Zbatimi i sistemit të meritokracisë bazuar në performancën individuale dhe ekipore.
- Përdorimi i teknologjisë së avancuar dhe digjitalizimi i proceseve për të optimizuar operacionet dhe për të rritur efikasitetin.
- Ngritja e kapaciteteve menaxheriale dhe teknike përmes programeve të specializuara të trajnimit.

5. Zhvillimi Profesional dhe Kërkimi i Tregut

- Trajnimi i vazhdueshëm i stafit për të përmirësuar aftësitë dhe për të siguruar përshtatshmërinë me kërkesat e tregut.
- Hulumtim i vazhdueshëm i tregut për të kuptuar dinamikën e kërkesës dhe për të zhvilluar strategji konkurruese.
- Ndryshimi i kulturës organizative për të promovuar qasje inovative dhe fleksibilitet në përshtatjen me zhvillimet teknologjike.

6. Mbështetja Institucionale dhe Rregullative

- Bashkëpunim i ngushtë me Qeverinë e Kosovës për mbështetje në zbatimin e kornizës ligjore postare.
- Ruajtja e ekskluzivitetit për ofrimin e shërbimeve postare universale.
- Sigurimi i mbështetjes financiare për realizimin e projekteve kapitale strategjike me rëndësi kombëtare.

Ky plan strategjik synon të forcojë pozitën e Postës së Kosovës në treg përmes një qasjeje të strukturuar dhe gjithëpërfshirëse, duke rritur cilësinë e shërbimeve, përmirësuar përvojën e konsumatorëve dhe zgjeruar ndikimin në tregun vendor.

Rreziqet kryesore dhe masat e menaxhimit në Postën e Kosovës Sh.A.

Posta e Kosovës Sh.A. është e angazhuar në menaxhimin strategjik të rreziqeve për të siguruar stabilitetin dhe zhvillimin afatgjatë. Identifikimi dhe adresimi i këtyre sfidave është thelbësor për të përmirësuar shërbimet dhe për të mbajtur pozitën e saj si operatori kryesor postar në vend.

Rreziqet e brendshme

1. Risku i teknologjisë së vjetruar

- Problemi: Sistemet e TI-së të vjetruara kufizojnë automatizimin e proceseve, rrisin vonesat dhe ndikojnë në cilësinë e shërbimeve postare dhe financiare.
- Zgjidhja: Ka nisur modernizimi i sistemit informativ për të digjitalizuar shërbimet dhe për të rritur sigurinë e të dhënave. Strategjia për avancimin e platformave online po e përmirëson ndërveprimin me klientët dhe partnerët.

2. Risku i infrastrukturës dhe flotës së transportit të amortizuar

- Problemi: Degët dhe qendrat postare të amortizuara, si dhe flota e vjetruar e transportit, ngadalësojnë shpërndarjen e shërbimeve dhe rrisin kostot operative.
- Zgjidhja: Është investuar në motoçikleta elektrike për postierët dhe furgonë të rinj për linjat e rregullta, duke rritur efikasitetin dhe ulur kostot. Po rinovohen degë postare dhe planifikohen investime të tjera infrastrukturore.

3. Risku i burimeve njerëzore

- Problemi: Moshë e lartë e stafit dhe mungesa e trajnimeve ndikojnë në produktivitet dhe inovacion.
- Zgjidhja: Po zbatohen programe trajnimi për përmirësimin e aftësive teknike dhe profesionale. Në proces është ristrukturimi, i cili synon optimizimin e operacioneve dhe riorganizimin e stafit sipas nevojave të tregut.

4. Risku financiar dhe i likuiditetit

- Problemi: Burimet financiare të kufizuara dhe vonesat në ekzekutimin e pagesave mund të ndikojnë në stabilitetin e ndërmarrjes.
- Zgjidhja: Po diversifikohen shërbimet financiare dhe postare për të rritur të hyrat. Po krijohen partneritete të reja për të siguruar burime shtesë financimi dhe për të garantuar likuiditetin për investime.

5. Risku i reputacionit dhe pajtueshmërisë ligjore

- Problemi: Mospërputhja me rregulloret ligjore dhe ankesat e klientëve mund të ndikojnë në besueshmërinë e Postës së Kosovës.
- Zgjidhja: Rregulloret e brendshme po përditësohen dhe po zbatohet një sistem më i rreptë monitorimi të cilësisë dhe standardeve etike.

6. Risku i sigurisë së informacionit

- Problemi: Kërcënimet kibernetike dhe mbrojtja e të dhënave paraqesin sfida serioze, sidomos me zgjerimin e shërbimeve online dhe financiare.
- Zgjidhja: Po forcohen masat e sigurisë duke avancuar sistemet e mbrojtjes kibernetike, rritur monitorimin dhe trajnuar vazhdimisht stafin për të parandaluar sulmet dhe rrjedhjet e të dhënave.

Rreziqet e jashtme

7. Risku nga zhvillimet teknologjike dhe platformat digjitale

- Problemi: Rritja e përdorimit të platformave digjitale për pagesa mund të reduktojë të hyrat e Postës së Kosovës.
- Zgjidhja: Po adaptohet strategjia për të krijuar linja të reja të ardhurash, si dhe pritjet zhvillimi i platformave online për pagesa dhe shërbime digjitale.

8. Risku i ndryshimeve ligjore dhe rregullatore

- Problemi: Ndryshimet në politikat shtetërore mund të ndikojnë në funksionimin dhe të hyrat e Postës së Kosovës.

- Zgjidhja: Po forcohet bashkëpunimi me institucionet për të siguruar përputhshmërinë ligjore dhe përshtatjen e strategjive të biznesit.

9. Risku i konkurrencës nga operatorët privatë

- Problemi: Operatorët privatë po rrisin konkurrencën në tregun postar, duke ndikuar në pjesën e tregut të Postës së Kosovës.
- Zgjidhja: Po investohet në përmirësimin e cilësisë dhe shpejtësisë së shërbimeve. Strategjia e re e marketingut synon të rrisë ndërgjegjësimin dhe besnikërinë e klientëve.

10. Risku ekonomik dhe inflacioni

- Problemi: Inflacioni dhe rënia e shitjeve online mund të ndikojnë në përdorimin e shërbimeve postare dhe kostot operative.
- Zgjidhja: Po analizohen mundësitë për optimizimin e kostove dhe përmirësimin e strukturës tarifore për të siguruar një model të qëndrueshëm financiar.

11. Risku i fatkeqësive natyrore dhe emergjencave

- Problemi: Përmbytjet, tërmetet apo pandemitë mund të ndërpresin shërbimet postare.
- Zgjidhja: Janë hartuar dhe po hartohen plane emergjente për të siguruar vazhdimësinë e operacioneve, duke përfshirë strategji alternative shpërndarjeje dhe fleksibilitet operativ.

Përfundim

Posta e Kosovës ka ndërmarrë hapa të rëndësishëm për menaxhimin e rreziqeve, duke investuar në infrastrukturë, teknologji dhe zhvillimin e stafit. Masat e implementuara dhe ato në proces synojnë të garantojnë një të ardhme të qëndrueshme dhe një shërbim më cilësor për qytetarët dhe bizneset.

Posta e Kosovës Sh.A.
Rr. 28 Nëntori nr. 4 Dardani,
Prishtinë, 10 000



www.postakosoves.com